



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:088625

Datë: 16.01.2023

Numri i dokumentit: 03858362

PKR.nr.263/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË–Departamenti për Krime të Rënda, në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtari Alban Ajvazi, kryetar i trupit gjykues dhe gjyqtarët profesionistë Shpresa Hasaj Hyseni dhe Avni Sylja, anëtarë të trupit gjykues, me bashkëpunëtoren profesionale Valbone Musa Lajçi, në çështjen penale kundër të akuzuarve A.A dhe A.V për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Vrasje e rëndë nga neni 179, par 1 pika 1.5 lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe secili veç e veç kanë kryer veprën penale Mbajtja ne pronësi, kontroll ose posedim te paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda PP/I.nr.238/2017 të dt.20.04.2018 dhe datës 12.07.2021, e precizuar me datë 19.11.2021,pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor me dt.09.12.2022, në të cilën kanë prezantuar prokurori i shtetit Ilaz Beqiri, të akuzuarit A.A me mbrojtësin e tij sipas autorizimit Av. Fitim Malokaj dhe A.V me mbrojtësin e tij sipas autorizimit Av. Florent Latifaj, i dëmtuari G.S prindi i të ndjerit dhe përfaqësuesi i të dëmtuarës R.K Av. Besim Tafa, me dt.13.12.2022 mori dhe shpalli publikisht, ndërsa me dt.16.01.2023 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër të akuzuarve:

A.A i biri i V dhe S., e gjinis L., i lindur me dt.... në P., me vendbanim në lagjen T., rruga “I. Sh.”, në P., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet në paraburgim prej dt.25.11.2017.

A.V i biri i N. dhe V., e gjinisë D., i lindur me dt.... në P., me vendbanim në rr. “N.G.”, nr.. në P., i pamartuar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet në paraburgim prej dt.27.05.2021.

JANË FAJTOR

Sepse:

I. Të akuzuarit A.A dhe A.V:

Me datë 24.11.2017 rreth orës 02:50 pranë kafiterisë Francisko që gjendet në rrugën “Fehmi Agani” në Prishtinë, të pandehurit A.V e A.A në bazë të marrëveshjes paraprake kanë privuar nga jeta tani të ndjerin N.S dhe rrezikuar jetën e tani të dëmtuarve B.S, L.K, F.F, R.K dhe M.K në atë mënyrë që pas kontaktit telefonik në mes të tani të ndjerit N.S me të pandehurin A.A, i pandehuri me veturën e tipit S...., ngjyrë e kuqe me targa të cilën e kishte marr me qira shkon tek kafiteria “Francisko”, takohet dhe fjaloset në mes veti, pastaj i pandehuri A.A shkon dhe e

merr tek shtëpia të pandehur A.V, që gjendet në lagjen Tokbashqe në Prishtinë, kthehen në vendin e ngjarjes ku prapë takohen me vëllezerit N. e B.S dhe pas fjalosjes të pandehurit largohen në drejtim të rrugës “Luan Haradinaj” pas pak kthehen në vendin e ngjarjes dhe derisa veturë ishte në lëvizje i pandehuri A.V nga ulësja e pasagjerit del në dritaren e automjetit dhe nga afërsia shtënë dy herë me revolen e tipit TT me numër serik XB 23930945 e kalibrit 7.62 mm, prodhim rus, me c’rast predha e rikoshetuar godet tani të ndjerin në pjesë e pasme të shpatullës së majtë ndërsa këmishëza e plumbit e godet në gishtin e mesëm të dorës së majtë tani të dëmtuarën R.K. Të cilët me tani të dëmtuarit B.S, L.K, F.F dhe M. K. ishin duke qëndruar afër veturës së të ndjerit në trotuar dhe të pandehurit me shpejtësi largohen nga vendi i ngjarjes, shkojnë deri tek rruga e “UCK” bëjnë gjysmërreth, kthehen prapë në vendin e ngjarjes dhe derisa vetura ishte në lëvizje e sipër i pandehuri A.V prapë shtënë edhe njëherë me armë dhe me shpejtësi largohet nga vendi i ngjarjes në drejtim të panjohur. Me c’rast nga plagët e marra tani i ndjeri N.S ndërron jetë në QKUK ndërsa e dëmtuara R.K ka pësuar lëndime të rënda trupore.

- Me këtë në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Vrasje e rëndë nga neni 179 par.1, pika 1.5 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

II. I akuzuari A.A

Nga data e papërcaktuar e deri me datë 25.11.2017 pa autorizim ka poseduar dy revole dhe atë revolen me të cilën është kryer vrasja e tani të ndjerit, e tipit TT me numër serik XB 23930945 e kalibrit 7.62 mm, prodhim rus, me një karikator dhe 8 fishekë, si dhe revolen e tipit Ecol Special, e kalibrit 9 mm PAK, me numër serik EV16120999 me një karikator, me 7 fishekë, si dhe 12 fishekë tjerë të kalibrit 7.35 mm, të cilët janë sekuestruar në dhomën nr. 50 në motelin “Villa Queens”, që gjendet në rrugën për Ferizaj, ku të pandehurit A.A dhe A.V kishin kaluar natën pas kryerjes së vrasjes.

- me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

III. I akuzuari A.V

Në kohë, vend e mënyrë si në pikën I të dispozitivit të kësaj aktakuze i pandehuri A.V pa autorizim ka poseduar revolen me të cilën e ka kryer vrasjen e tani të ndjerit N.S e tipit TT me numër serik XB 23930945 e kalibrit 7.62 mm, prodhim rus.

- me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

Prandaj, gjykata konform dispozitave 2, 4, 17, 41, 45, 73, 178 të KPRK-së, si dhe nenet 359, 365, 366, 367, 368, 450, 453, dhe 463 të KPRK-së, të akuzuarve iu:

CAKTON

- Për veprën penale të përshkruar si në diapozitivin e parë secilit veç e veç iu shqipton dënim me burgim efektiv në kohëzgjatje prej 20 (njëzetë) vitesh.
- Për veprën penale të përshkruar si në diapozitivin e dytë të akuzuarit A.A i shqipton dënim me burgim efektiv në kohëzgjatje prej 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj.

- Për veprën penale të përshkruar si në diapozitivin e tretë të akuzuarit A.V i shqipton dënim me burgim efektiv në kohëzgjatje prej 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj.

Andaj gjykata konform nenit 80, të KPRK-së të akuzuarit:

I G J Y K O N

- I.** Secilit veç e veç iu shqipton dënim unik **DËNIM ME BURGIM** në kohëzgjatje prej **(njëzet e një) 21 vite**, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II.** Të akuzuarve në dënimin e shqiptuar do t'iu llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim- arrest shtëpiak, të akuzuarit A.A prej dt.07.09.2019 deri me datë 29.12.2020 dhe nga data 28.03.2021 e tutje, ndërsa të akuzuarit A.V prej datës 27.05.2021 e tutje.
- III.** Të akuzuarve me aktvendim të veçantë iu është vazhduar masa e paraburgimit deri në plotfuqishmëri të aktgjykimit por jo më gjatë se dënimi i shqiptuar.
- IV.** Të akuzuarit obligohen që t'i paguajnë shpenzimet e procedurës penale dhe atë, në emër të paushallit gjyqësor shumë prej pesëqind (500) euro, kurse në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumë prej pesëdhjetë (50) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- V.** Gjykata në mbështetje të nenit 282 par.1 të KPRK-së si dhe nenit 374 par.3 të KPRK-së, nxjerrë këtë:
URDHËR - URDHËROHET konfiskimi i përhershëm i sendeve si në vijim: Revolja e tipit "TT" me nr.XB23930945 e kal 7.62 prodhim rus dhe Revolja e tipit "Ekol Special" e kal 9 mm me nr.serik EV16120999, me nje karikator me 7 fishekë si dhe 12 fishekë tjerë të kal.7.355 mm.
- VI.** Pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, këto armë duhet të shkatërrohen nga Policia e Kosovës, në bashkëpunimin me Prokurorinë Themelore në Prishtinë.
- VII.** Të dëmtuarit G.S, B.S dhe R.K për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohen në kontest civil.

A r s y e t i m

Rrjedha e procedurës:

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, ka paraqitur aktakuzën PP/I.nr.238/2017 të dt.20.04.2018 kundër të akuzuarit A.A për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale në bashkëkryerje Vrasje e rëndë nga neni 179 par 1 pika 1.5 lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par 1 të KPRK-së.

Gjykata Themelore në Prishtinë me aktgjykimin PKR.nr.100/18 të datës 16.04.2019 të akuzuarin A.A e ka shpallur fajtor.

Gjykata e Apelit me datë 17.10.2019 me aktvendimin nr. PAKR.nr.442/2019, ka aprovuar ankesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë dhe ankesën e mbrojtësit të akuzuarit A.A, ka

anuluar aktgjykimin e gjykatës themelore në Prishtinë dhe çështjen e ka kthyer në shkallë të parë në rigjykim dhe rivendosje.

Prokuroria Themelore në Prishtinë ka ngritur aktakuzën me numër PP/I.nr.238/2017 të datës 12.07.2021 kundër të akuzuarit A.V për shkak të dyshimit të bazuar se në bashkëkryerje ka kryer veprën penale Vrasje e rëndë nga neni 179 par 1 pika 1.5 lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par 1 të KPRK-së.

Gjykata Themelore në Prishtinë duke vepruar sipas detyrës zyrtare me qëllim të efikasitetit të procedurës penale dhe ekonomizimit të procedurës, me aktvendimin PKR.nr.263/2019 të datës 18.11.2021 ka bashkuar procedurën penale kundër të pandehurve A.A e evidentuar pranë kësaj gjykate me numër të lëndës PKR.nr.263/2019 dhe A.V e evidentuar pranë kësaj gjykate me numër PKR.nr.412/2021 dhe procedura ka vazhduar për dy aktakuzat e ngritura nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda PP.I.nr.238/2017 të datës 20.04.2018 dhe PP.I.nr.238/2017 të datës 12.07.2021 për veprën penale në bashkëkryerje Vrasje e rëndë nga neni 179 par 1 pika 1.5 lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe secili veç e veç veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par 1 të KPRK-së.

Gjykata lidhur me këtë çështje penale ka caktuar seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 19.11.2021 në të cilën seancë kanë prezantuar: Prokurori i Shtetit Ilaz Beqiri, i pandehuri A.A, me mbrojtësin e tij sipas autorizimit Av. Asdren Hoxha, i pandehuri A.V, me mbrojtësin e tij sipas autorizimit Av. Florent Latifaj, prindi i te ndjerit G.S, me përfaqësuesin Av. Nexhmedin Sejdiu, te dëmtuarit- dëshmitaret B.S me përfaqësuesin Av. Fanol Krasniqi, R.K me përfaqësuesin Av. Adrian Islami sipas autorizimit zëvendësues në të cilën seance prokurori i shtetit ka deklaruar se: Meqë në këtë çështje penale në kohë të ndryshme janë ngritur dy aktakuza do të bëjë unifikimin e dispozitivit të aktakuzës për të pandehurit ashtu që dispozitivi i parë i aktakuzës duhet të jetë:

I.“Sepse me datë 24.11.2017 rreth orës 02:50 pranë kafiterisë Francisko që gjendet në rrugën “Fehmi Agani” në Prishtinë, të pandehurit A.V e A.A në bazë të marrëveshjes paraprake kanë privuar nga jeta tani të ndjerin N.S dhe rrezikuar jetën e tani të dëmtuarve B.S, L.K, F.F, R.K dhe M.K në atë mënyrë që pas kontaktit telefonik në mes të tani të ndjerit N.S me të pandehurin A.A, i pandehuri me veturën e tipit Seat Alteo, ngjyrë e kuqe me targa 01-936JN të cilën e kishte marr me qira shkon tek kafiteria “Francisko”, takohet dhe fjaloset në mes veti, pastaj i pandehuri A.A shkon dhe e merr tek shtëpia të pandehurin A.V, që gjendet në lagjen Tokbashqe në Prishtinë, kthehen në vendin e ngjarjes ku prapë takohen me vëllezerit N e B.S dhe pas fjalosjes të pandehurit largohen në drejtim të rrugës “Luan Haradinaj” pas pak kthehen në vendin e ngjarjes dhe derisa veturë ishte në lëvizje i pandehuri A.V nga ulësja e pasagjerit del në dritaren e automjetit dhe nga afërsia shtënë dy herë me revolen e tipit TT me numër serik XB 23930945 e kalibrit 7.62 mm, prodhim rus, me c’rast predha e rikoshetuar godet tani të ndjerin në pjesë e pasme të shpatullës së majtë ndërsa këmishëza e plumbit e godet në gishtin e mesëm të dorës së majtë tani të dëmtuarën R.K. Të cilët me tani të dëmtuarit B.S, L.K, F.F dhe M K ishin duke qëndruar afër veturës së të ndjerit në trotuar dhe të pandehurit me shpejtësi largohen nga vendi i ngjarjes, shkojnë deri tek rruga e “UCK” bëjnë gjysmërreth, kthehen prapë në vendin e ngjarjes dhe derisa vetura ishte në lëvizje e sipër i pandehuri A.V prapë shtënë edhe njëherë me armë dhe me shpejtësi largohet nga vendi i ngjarjes në drejtim të panjohur. Me c’rast nga plagët e marra tani i ndjeri N.S ndërron jetë në QKUK ndërsa e dëmtuara R.K ka pësuar lëndime të rënda trupore.

Me këtë në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Vrasje e rëndë nga neni 179 par.1, pika 1.5 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Ndërsa sa i përket pikës II të dispozitivit duhet të jetë:

I pandehuri A.A nga data e papërcaktuar e deri me datë 25.11.2017 pa autorizim ka poseduar dy revole dhe atë revolen me të cilën është kryer vrasja e tani të ndjerit, e tipit TT me numër serik XB 23930945 e kalibrit 7.62 mm, prodhim rus, me një karikator dhe 8 fishekë, si dhe revolen e tipit Ecol Special, e kalibrit 9 mm PAK, me numër serik EV16120999 me një karikator, me 7 fishekë, si dhe 12 fishekë tjerë të kalibrit 7.35 mm, të cilët janë sekuestruar në dhomën nr. 50 në motelin “Villa Queens”, që gjendet në rrugën për Ferizaj, ku të pandehurit A.A dhe A.V kishin kaluar natën pas kryerjes së vrasjes.

Me këtë i pandehuri A.A ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

Dhe në pikën III të dispozitivit kundër të pandehurit A.V.

Në kohë, vend e mënyrë si në pikën I të dispozitivit të kësaj aktakuze i pandehuri A.V pa autorizim ka poseduar revolen me të cilën e ka kryer vrasjen e tani të ndjerit N.S e tipit TT me numër serik XB 23930945 e kalibrit 7.62 mm, prodhim rus.

Me këtë i pandehuri A.V ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur rishtazi shqyrtimin gjyqësor me datë 06.06.2022 për shkak të kalimit të afatit prej 3 muajve nga mbajtja e seancës së fundit të shqyrtimit gjyqësor në të cilën seancë të akuzuarit janë deklaruar lidhur me fajësinë apo pafajësinë e aktakuzës, ku i akuzuari A.A u deklarua i pafajshëm sa i përket dispozitivit I të aktakuzës ndërsa sa i përket pikës II të dispozitivit të aktakuzës deklarohet fajtor, konkretisht veprës penale nga neni 374 par.1 të KPRK-së, ndërsa i akuzuari A.V u deklarua i pafajshëm për dy pikat e aktakuzës.

Prokurori i shtetit sa i përket pranimin të fajësisë nga i pandehuri A.A, sa i përket veprës penale nga neni 374 par 1 ka deklaruar se: Pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit A.A sa i përket veprës penale nga neni 374 par.1, pasi që i njëjti konsideroj se është konsultuar mjaftueshëm me mbrojtësin e tij, ka kuptuar benifitet dhe pasojat e pranimin të fajësisë dhe se një pranim i tillë është në përputhshmëri të plotë me të gjitha provat që gjenden në shkresat e lëndës. Andaj i propozojmë gjykatës që të aprovohet një pranim i tillë.

Mbrojtësi i të pandehurit A.A lidhur me pranimin e fajësisë sa i përket pikës II të dispozitivit të aktakuzës, Av. Asdren Hoxha ka deklaruar se: Pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit tim për veprën penale nga pika II e aktakuzës përkatësisht Mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 të KPRK-së duke konsideruar se pranimi i të mbrojturit tim është i vullnetshëm, në konsultim të mjaftueshëm me mua si mbrojtës dhe në përputhje me provat që gjenden në shkresat e lëndës. Andaj vlerësoj se janë përmbushur kushtet ligjore, si dhe është në përputhje me dispozitën e nenit 248 të KPPK-së duke i propozuar gjykatës që ta aprovoj.

Gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit A.A sa i përket veprës penale nga neni 374 par.1 të KPRK-së, pasi që i njëjti është bërë në mënyrë vullnetare pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij dhe mbështetet në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, ndërsa duke u bazuar në nenin 327 të KPPK-së, ka vazhduar seancën e shqyrtimit gjyqësor me

prezantimin e provave dhe fjalën përfundimtare për të akuzuarin A.A sa i përket pikës I të dispozitivit të aktakuzës dhe të akuzuarit A.V për pikën I dhe III të aktakuzës.

Gjykata ka vazhduar me shqyrtimin gjyqësor është dhënë fjala hyrëse e palëve, janë dëgjuar të dëmtuarit në cilësinë e dëshmitarëve B.S, L.K, F.F, R.K, është lexuar deklarata e të dëmtuarit-dëshmitarit M. K. dhënë në polici me datë 24.11.2017, është dëgjuar eksperti i mjekësisë ligjore Dr.Arsim Gërxfhaliu, është lexuar mendimi i ekspertit të balistikës Hazir Kelmendi i datës 16.02.2018, si dhe është bërë shikimi i videoinqizimit i datës 24.11.2017 marrë nga lokali ‘Optika’. Gjithashtu në këtë çështje penale është bërë administrimi i provave, është dhënë mbrojtja e të akuzuarve si dhe është dhënë fjala përfundimtare e palëve.

Fjala përfundimtare e palëve:

Prokurori i shtetit pas administrimit të provave materiale, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: Me provat e administruara në këtë shqyrtim gjyqësor pa asnjë mëdyshje e në mënyrë të plotë dhe të qartë u vërtetua se të pandehurit A.A dhe A.V në bazë të marrëveshjes paraprake privuan nga jeta tani të ndjerin N.S dhe drejtpërsëdrejti rrezikuan edhe jetën e tani të dëmtuarve R.K, B.S, F.F, L.K dhe M.K në atë mënyrë që pas fjalosjes paraprake mes të pandehurit A.A dhe tani të ndjerit N.S i pandehuri me veturën e tipit S. A ngjyrë e kuqe, me targa 01-... shkoi tek shtëpia e të pandehurit A.V, e mori të njëjtit dhe pas marrëveshjes paraprake, e me qëllim që ta privojnë nga jeta tani të ndjerin u kthyen në vendin e ngjarjes, u takuan me vëllezërit N e B.S, u rifjalosën në mes veti dhe për një moment të pandehurit u larguan me veturë në drejtim të rrugës “Luan Haradinaj” dhe derisa tani i ndjeri me të dëmtuarit ishin duke u ndarë mes veti me qëllim që të kthehen në shtëpi në vend të ngjarjes u kthyen të pandehurit me veturë të cilën e drejtonte i pandehuri Arlind, ndërsa i pandehuri A.V del në dritaren e automjetit dhe me qëllim që ta privojë nga jeta tani të ndjerin N. derisa vetura ishte në lëvizje me shpejtësi nga afërsia shtënë dy here me revolen e tipit TT në drejtim të të ndjerit, me ç’rast predha e rikoshetuar godet tani të ndjerin në pjesën e pasme të shpatullës së majtë ndërsa këmishëza e plumbit e godet në gishtin e mesëm të dorës së majtë tani të dëmtuarën R.K dhe drejtpërdrejtë rrezikojnë edhe jetën e të dëmtuarve B.S, L.K, F.F dhe M.K. dhe më pastaj të pandehurit me shpejtësi largohen në drejtim të rrugës “UÇK” , shkojnë deri tek objekti i ish bankës së Lublanës, bëjnë në gjysmë rreth dhe në shenjë krenarie kthehen prapë në vendin e ngjarjes ku i pandehuri A.V shtënë edhe njëherë me revole në ajër, e më pastaj largohen në drejtim të panjohur.

Se të pandehurit kryen këto vepra penale u vërtetua nga dëshmitë e dëshmitarëve- të dëmtuarve R.K, B.S, L.K, F.F dhe M.K të cilët në këtë shqyrtim gjyqësor në mënyrë të plotë, të qartë, bindëse dhe identike përshkruan veprimet inkriminuese të të pandehurve duke deklaruar se derisa ishin duke festuar ditëlindjen e tani të dëmtuarit F në kafiterinë “Francisko” për një moment në mënyrë jo të zakonshme nga kafiteria dalin vëllezërit S dhe nga kureshtja pastaj dalin edhe dëshmitarët, ku vërejnë vëllezërit S duke u fjalosur me tani të pandehurit që gjendeshin në veturën S., vërejnë se për një moment vetura largohet në drejtim të rr.”Luan Haradinaj” ndërsa tani të dëmtuarit afrohen tek vetura BMW dhe derisa ishin duke u përshëndetur mes veti në vendin e ngjarjes kthehet vetura prapë me shpejtësi, ku nga vetura shohin personin duke shtënë në drejtim të të ndjerit. Më pastaj largohen në drejtim të rr. “UCK” me ç’rast plagë vdekjeprurëse merr i ndjeri N ndërsa lëndime të rënda pëson e dëmtuara R.K. Këto dëshmi të dëshmitarëve-të dëmtuarve gjykata në tërësi duhet tua fal besimin pasi që të njëjtat janë në përputhshmëri të plotë me provat materiale që janë administruar në këtë shqyrtim gjyqësor, si dhe videoincizimet e para në këtë shqyrtim gjyqësor. Ka theksuar se të pandehurit kryen këto vepra penale u vërtetua edhe me administrimin e provave materiale dhe atë: raporti i autopsisë me shenjë MA17-311 nga Dr.

Arsim Gërxhaliu për të ndjerin N.S e nga i cili rezulton se vdekja e tani të ndjerit N u shkaktua nga predha e armës së zjarrit e cila i dëmtoi pjesët vitale të trupit të të ndjerit dhe si pasojë e tyre i ndjeri në QKUK ndërroi jetë. Këtë mendim në këtë shqyrtim gjyqësor e elaboroi edhe vet eksperti i cili deklaroi që mbetet në tërësi pranë raportit të hartuar me shkrim. Mendimi i ekspertit të balistikës Prof. Hazir Kelmendi i datës 16.02.2018 nga i cili rezulton se sulmi është kryer me revolën e tipit TT, nga afërsia e derisa vetura ishte në lëvizje. Mendimi i ekspertit Dr. Arsim Gërxhaliu për të dëmtuarën R.K nga i cili vërtetohet se me rastin e atij sulmi e dëmtuara pësoi lëndime të rënda trupore në gishtin e mesëm të dorës së majtë. Videoincizimi i bartur në CD i cili mbulon vendin e ngjarjes së bashku me raportin analitik të atij videoincizimi, e që me atë videoincizim vërtetohet se dëshmitë e dëshmitarve janë identike për rrjedhën e ngjarjes me videoincizimin që është shikuar në këtë shqyrtim gjyqësor. Andaj i propozoj trupit gjykues që të pandehurit për këto vepra penale të shpallen fajtor dhe të gjykohen sipas ligjit dhe me rastin e matjes dhe shqiptimit të sanksionit penal gjykata si rrethana rënduese të merr edhe faktet se u privua një person i moshës së re nga jeta, tani i ndjeri N.S, vendosmëria e të pandehurve për kryerjen e veprave dhe shkaktimin e atyre pasojave, e që u manifestua me vet faktin që të pandehurit disa herë u kthyen në vendin ne ngjarjes para se i ndjeri të privohet nga jeta, edhe pas shkaktimit të plagës vdekjeprurëse prapë të pandehurit në shenjë krenarie kthehen në vendin e ngjarjes dhe i pandehuri A shtënë edhe njëherë me revole në ajër.

Përfaqësuesi i G.S prindi i të ndjerit, Av. Nexhmedin Sejdiu, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: Duke u mbështetur në plotni në fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit, duke shtuar se në rastin penal kemi të bëjmë me humbjen e jetës së një të riu të moshës 33 vjeçe, i cili natën kritike ishte privuar nga jeta nga tani të pandehurit A.V dhe A.A, nën rrethanat që besojmë që janë sqaruar dhe vërtetuar mjaftueshëm me provat materiale dhe formale gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor, marrë parasysh se tani gati qe 2 vjet është duke u trajtuar nga ky trup gjykues kjo çështje penale ku janë vërtetuar pohimet e akuzatorit në plotni deri më tani me prova të pakontestueshme si formale ashtu edhe materiale, në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të palëve të dëmtuara i propozoj këtij trupi gjykues që pas këtij shqyrtimi gjyqësor të pandehurit t'i shpall fajtor dhe t'i dënojë sipas ligjit dhe konform nenit 462 të KPPRK-së ta shqyrtojë kërkesën tonë pasurore juridike të cilën e kemi përgatitur me shkrim e të cilën do t'ia deponojmë këtij trupi gjykues.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar R.K, Av. Besim Tafa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: E mbështes fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit ngase nga provat materiale dhe personale të cilat janë administruar në këtë shqyrtim gjyqësor është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se të pandehurit e kanë kryer veprën penale me të cilën i ngarkon aktakuza. Meqenëse pala e dëmtuar që unë e përfaqësoj R.K ka pësuar lëndime të rënda trupore nga veprimet e kundërligjshme të pandehurit paraqes kërkesë pasurore juridike dhe kërkoj nga gjykata që t'i obligojë të pandehurit që t'ia kompensojnë dëmin të cilin të pandehurit ia kanë shkaktuar palës së dëmtuar R.K, ndërsa në lidhje me shumën kjo shumë të caktohet në procedurë civile ngase përcaktimi i shumës në këtë procedurë do të zgjasë procedurën dhe nuk është në interes të palës që unë e përfaqësoj.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.A, av. Fitim Malokaj fjalën përfundimtare e ka dorëzuar me shkrim duke shtuar se: Në fund të kësaj fjalë përfundimtare para se të jap propozimin tim dua të theksoj publikisht se me ndërgjegje të thellë jam i bindur se drejtësia mund të vihet në vend vetëm nëse të mbrojturin tim e gjen fajtor për veprën penale Ndihma nga neni 33 në drejtim të veprës penale Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par.5 të KPRK-së ngase drejtësia mund të vihet në vend nëse gjykata gjen fajësinë për veprën penale që manifestohet me veprimet e tij, e jo për veprën penale për të cilën nuk e ka kryer. Po ashtu edhe për veprën penale Mbajtja në

pronësi, kontroll, posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së të cilën i mbrojturi im e ka pranuar në shqyrtimin fillestar. Ndër të tjera në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim ka deklaruar se: Prokuroria nuk ka arritë të vërtetoj teorinë e akuzës, përkatësisht nuk është arritë të vërtetohet se A.A ka kryer veprën penale Vrasje e Rëndë në bashkëkryerje dhe nuk janë vërtetuar me saktësi të plotë rrethanat dhe faktet vendimtare të çështjes në fjalë, e kjo për faktin se kjo vepër mund të kryhet vetëm me dashje, me dashje të drejtëpërdrejt apo me dashje eventuale. Nga provat e administruara është sqaruar se A.A nuk ka vepru me dashje të drejtëpërdrejt e kjo është vërtetu nga ekspertiza balistike me shkrim se personi që ka shti me armë natën kritike ka qenë jo më larg se 2 metra nga i ndjeri dhe ka shti me dorën te poshtë pra jo në drejtim të trupit të ndjerit, gjithashtu nuk ka ekzistuar as dashja eventuale sepse nuk është administru asnjë provë e vetme formale apo materiale në drejtim të vërtetimit të dashjes eventuale. Ka theksuar se nga ekspertiza balistike dhe dëshmia e dëshmitarit ekspertit Hazir Kelmendi është vërtetuar se është shtënë në një kënd prej 70 shkallësh në drejtim të asfaltit dhe nëse kemi për bazë faktin se dorën e ka qit jashtë dritares nuk e ka drejtuar në drejtim të trupit të ndjerit në një kënd prej 45 shkallësh por e ka kthyer në drejtim të asfaltit përkatësisht gomave të veturës dhe e ka kthyer aq sa ka mundur pra në një kënd prej 70 shkallësh ngase në kënd prej 90 shkallësh nuk ka mundur fizikisht ta realizon andaj nuk mund të thuhet se me veprimin në fjalë ka qenë i vetëdijshëm se mund të shkaktohet pasoja e ndaluar (privimi nga jeta) dhe të jetë pajtu apo dakordu me këtë pasojë. Personi që ka shti me armë nuk ka mundur që të parasheh lëvizjen e plumbave rikoshet, nuk ka mundur të dijë se a do të rikoshetohet apo jo. Ka shtuar se Vrasja e rëndë në bashkëkryerje nuk mund të kryhet pa marrëveshje paraprake e në këtë rast nuk ka provë konkrete formale apo materiale e cila është administru për të vërtetuar marrëveshjen paraprake përkundrazi nga transkriptet telefonike që janë pjesë e shkresave të lëndës shihet se i mbrojturi im flet në dy transkripte me një person NN femër dhe merren vesh për tu taku pra ka pas plane të tjera të mëhershme pra e kundërta e ekzistimi të marrëveshjes paraprake për të cilën pretendon prokuroria. Ka shtuar se nuk është vërtetuar me asnjë provë dispozitivi i aktakuzës rreshtat 8, 9, 10 dhe 11 ngase nuk është vërtetuar kurrfarë fjalosje në mes të N.S dhe A.A ngase nuk është argumentu se nga cila provë është vërtetuar kjo fjalosje, po ashtu nga transkriptet telefonike shihet se nuk ekziston asnjë bisedë në mes të A.At dhe A.Vt. Ka theksuar se me qenëse nuk është vërtetuar në asnjë mënyrë ekzistimi i dashjes dhe marrëveshjes paraprake si elemente qenësore të veprës penale Vrasje e rëndë në bashkëkryerje konsideroj se natën kritike në veprimet e të mbrojturit tim manifestohen elementet e veprës penale Ndihma nga neni 33 të KPRK-së lidhur me veprën penale shkaktim i rrezikut të prgjithshëm me pasoja fatale nga neni 365 par 5 të KPRK-së, e kjo për faktin se natën kritike është shtënë në drejtim të asfaltit pra ka ekzistuar dashja vetëm për shkaktim të rrezikut të përgjithshëm kurse A.A me vënien e mjeteve në dispozicion i ka dhënë ndihm një personi në kryerjen e veprës penale shkaktim i rrezikut të përgjithshëm me pasoja fatale.

I akuzuari A.A, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: E përkrah fjalën përfundimtare të mbrojtësit duke shtuar se i vie keq për rastin që ka ndodhur.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.V, av. Florent Latifaj, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: E përkrah fjalën përfundimtare të dhënë nga mbrojtësi Av. Fitim Malokaj dhe shtoj se me të drejtë do të konsiderohej si i vetmi vendim i drejtë në këtë çështje penale juridike rikualifikimi i veprës penale nga Vrasje e rëndë në bashkëkryerje në veprën penale Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm me pasojë vdekjen. Kur e them këtë kam parasysh faktin se në këtë shqyrtim gjyqësor janë administruar dy prova dhe është dëgjuar një ekspert me datën 08.11.2022 të cilët medoemos na shtënë në drejtim të konsiderimit të elementeve të veprës penale të propozuar nga ne. Kur them këtë kam parasysh faktet si në vijim: nuk është kontestuar as nga ana e prokurorit, as nga ana e askujt se plumbi që ka goditur tani të ndjerin ka ardhur si rezultat i predhës së rikoshetuar ashtu

siç kanë deklaruar edhe ekspertet dhe ashtu siç është e paraparë në dispozitiv të aktakuzës. Eksperti Arsim Gërxhaliu në deklaratën e tij të dhënë në këtë shqyrtim gjyqësor në faqen 4, në pyetjen e parafundit kishte deklaruar se “Predha ka hyrë në organizëm nga poshtë- lart dhe gjithashtu ka shkuar nga para- djathtas”, në po të njëjtën faqe kah mes i faqes i njëjti kishte deklaruar se “Në rastin konkret predha ishte dukshëm e dëmtuar”, që d.m.th se dëmtimi kishte ndodhur jashtë organizmit. Kur krejt kësaj ia shtojmë edhe mendimin e ekspertit të balistikës kriminalistike i cili në ekspertizën e tij deklaroi se “Pozicioni i dorës në momentin e shtënjes ka qenë në një kënd më të vogël se 70 shkallë”, që i bie të jetë dora pothuajse e lëshuar poshtë. E kur krejt kësaj ia shtojmë faktin se distanca mes tani të ndjerit dhe personit që ka shtënë nga vetura ka qenë prej 1 deri në 2 metra atëherë cila ka qenë arsyeja që një person që dëshiron ta vret dikënd mos të gjuaj në drejtim të tij prej 2m por në drejtim të tokës. Ky fakt na bën të besojmë detyrimisht se qëllimi asnjëherë nuk ka qenë vrasja e ndokujt por ndoshta zmbropsja e sulmit të atëçastshëm, të paprovokuar, ndoshta frika e madhe që sa më shpejt të ikin nga vendi i ngjarjes, krejt këto e bëjnë dikënd që në distancë prej 2 metra mos të shtënë në trup por në tokë. Gjithashtu edhe sa i përket vendit të ngjarjes dhe CD të shikuar në këtë shqyrtim gjyqësor përkundër asaj që pretendonte prokuroria se me shikimin e CD u vërtetua teoria e tij e paraqitur në aktakuzë na dëshmojë diçka tjetër se në asnjë moment nuk kemi mundur me pa momentin kritik të shtënjes së armës. E nga rikonstruimi i vendit të ngjarjes të bërë nga eksperti i balistikës në faqen e parë, tek pjesa e parë pas konstatim dhe mendim përshkruhet një ngjarje krejt tjetër dhe me një vend shumë më larg se ai vend që pretendonte prokurori. Së paku aty thotë eksperti janë gjetur disa njolla gjaku, gëzhoja, trotuar i dëmtuar nga predhat e shkrepjes. Andaj konsideroj se gjykata duhet medoemos t’ua fal besimin dy ekspertizave të nxjerra për këtë çështje e të cilat detyrimisht e orientojnë gjykatën në rikualifikimin e kësaj vepre penale sepse ajo është e vetmja që mundet kjo gjykatë nga këto prova të administruara në këtë shqyrtim gjyqësor të nxjerrë dhe do të ishte i vetmi mendim i drejtë dhe i ligjshëm.

I akuzuari A.V, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: E përkrahi fjalën përfundimtare të mbrojtësit dhe shton se më vjen keq për ngjarjen që ka ndodhur, asnjëherë në jetë nuk kam dashur me ia marrë jetën dikujt, apo me ja rreziku jetën dikujt.

Provat e administruara:

Me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike në këtë ç’ështëje penale, gjykata ka dëgjuar të dëmtuarit-dëshmitarët B.S, L.K, F.F, R.K, është lexuar deklarata e të dëmtuarit-dëshmitarit M K, si dhe ka administruar provat materiale: Raporti i autopsisë MA 17-319 nga eksperti Dr. Arsim Gërxhaliu për të ndjerin N.S nga i cili rezulton se deri tek vdekja e tani të ndjerit N.S ka ardhur si pasojë e veprimit dinamik të armës së zjarrit. Mendimi i ekspertit mjekoligjor Dr. Arsim Gërxhaliu për të dëmtuarën R.K nga i cili rezulton se e dëmtuara R.K nga e shtëna me armë nga ana e të pandehurit A.V, e njëjta pësoi lëndime të rënda trupore. Mendimi i ekspertit të balistikës Prof. Hazir Kelmendi i dt: 16.02.2018 i cili në hollësi ka përshkruar trajektoret e predhave të armës me të cilat është qëlluar tani i ndjeri. Raporti i ekspertimit me nr. AKF 2018-0104/2018-99, i dt. 24.01.2018, AKF 2018-0104/2018-98 i dt: 25.01.2018, AKF 2018-0104/2018-0008 i dt.23.01.2018, AKF 2018 -0104/2018-0008 i dt. 26.01.2018, Raporti përcjellës i policisë së Kosovës, Njësisë hetimeve rajonale në Prishtinë me nr.reference 06/2-02/162/15 i datës 25.01.2018 si dhe transkriptet e bisedave të shkruara më fjalë në 18 faqe, shiqimi i videoinqizimit të bartur në CD, si dhe fotodokumentacioni nga të cilat shihet vendi i ngjarjes dhe provat e mbetura në vendin e ngjarjes.

I dëmtuari/dëshmitari B.S në dëshminë e dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se: A.An dhe A.Vn i kam njohur por nuk kam pasur shoqëri me ta dhe nuk kemi pasur ndonjë telashe me ta. Natën kritike Fi e ka pasur ditëlindjen dhe më ka thirr bashkë me Nin dhe kemi shku për qef

në kafeterinë “Francisko” në rrugën “Fehmi Agani” nuk më kujtohet ora por ka qenë mbrëmje, kemi pirë naj gotë verë por nuk kemi qenë të dehur. Ka shtuar se e di se Ni i kish pas mbetur borxh At atë natë, ka qenë një borxh i vogël dhe ka qenë për shkak të narkotikëve pasi që A ka qenë shitës i narkotikëve, dhe kur N ka dalur i pari na kafja pastaj unë nuk kam parë kurrgjë por kam ni fjalosje mes vëllait tim N dhe A dhe nga aty A ka shkuar dikund dhe çështje minutash është kthyer vet i dyti për herën e dytë, ka shtuar se nuk më kujtohet saktë mirëpo deklaramin që e kam dhënë në prokurori e kam deklaruar të vërtetën dhe mbetem në tërësi pranë atij deklaramin. Më kujtohet se kam dëgjuar krisma por nuk e di sa, momentin që është plagu N ne kemi qenë ngjitas dhe aty me neve ka qenë edhe F ndërsa L, M dhe R kanë qenë afër. Ka shtuar se momentin e parë kur kanë shtënë me armë nuk e kam parë pasi që kanë shtënë pas shpine ndërsa herën e dytë e kam parë, të shtënat i ka bërë Ai dhe e shtëna e dytë të cilën e kam parë unë Ai ka dalë nga dritarja duart i ka vendos mbi kulm të kerrit dhe ka shti në drejtim tonin ku është lënduar edhe R. K shtuar se pasi kanë përfunduar të shtënat N ka fillu me ni dhimbje dhe më thotë mua a po më kqyr mbrapa se po dhem diçka, unë e kam marr ja kom qu duksin lart dhe e kam parë duke i rrjedhur gjak mbrapa në shpinë, pastaj me veturën tonë e kemi dërguar në QKUK, i njëjti ka qenë gjallë derisa ka shkuar në QKUK dhe pas gjysmë apo një ore na kanë njoftuar mjekët se ka vdekur.

Gjykata me kujdes të veçantë ka vlerësuar dëshminë e këtij dëshmitari dhe të njëjtën e ka vlerësuar si reale, objektive, se i njëjti ka qenë konsistent edhe me deklaramet e tij të mëparshme në këtë çështje penale në raport më përshkrimin e ngjarjes, se si ka ndodh ngjarja, e po ashtu edhe në përshkrimin dhe mënyrën se si ka ndodhur ngjarja dhe gjithashtu dëshmia e dëshmitarit gjën mbështetje të plotë në provat tjera siç janë dëshmitë e dëshmitarëve L.K, R.K, M K, F.F si dhe provave materiale të administruar në këtë çështje penale siç janë: Raporti i autopsisë MA nga eksperti Dr. Arsim Gërxhaliu, Mendimi i ekspertit mjekoligjor Dr. Arsim Gërxhaliu për të dëmtuarën R.K nga i cili rezulton se e dëmtuara R.K, Mendimi i ekspertit të balistikes Prof. Hazir Kelmendi i dt: 16.02.2018 si dhe provave të tjera të administruara në këtë çështje penale, se natën kritike derisa sa kanë qenë duke festuar ditëlindjen e Fit në kafiterinë “Francisko” në rrugën “Fehmi Agani”, në Prishtinë, kanë dalë jashtë lokalit dhe pas një mosmarrëveshje paraprake mes të vëllaut të tij tani i ndjerë N.S dhe A për një borxh, dhe nga aty A ka shkuar dikund dhe është kthyer vet i dyti dhe herën e dytë kur janë kthyer të akuzuarit, i dëmtuari ka dëgjuar të shtëna me armë por nuk i ka parë sepse ka qenë kthyer me shpinë mbrapa ndërsa të shtënë e dytë pohon se e ka parë dhe ka qenë nga Ai i cili ka dalë nga dritarja duart i ka vendos mbi kulm të veturës dhe ka shtënë në drejtim të tyre, dhe pasi kanë përfunduar të shtënat N ka fillu me ni dhimbje dhe kur e ka shiku tani të ndjerin e ka parë duke i rrjedhur gjak mbrapa në shpinë, pastaj me veturë e kanë dërguar në QKUK dhe pas një kohe, rreth një orë më vonë janë njoftuar nga mjekët se N.S ka vdekur, nga këto të shtëna ka pohuar se është lënduar edhe R, e cila ka qenë afër tyre së bashku me L, M dhe F.

Dëshmitari L.K në dëshminë e dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se: Natën në mes të datës 23.11.2017 dhe 24.11.2017 kam qenë në kafiterinë “Francisko” që gjendet në rrugën “Fehmi Agani” dhe pasi që F e ka pas ditëlindjen më ka pyetur se a mundet mi ftu edhe disa miq të tij dhe pas aprovimit tim në mbrëmje vonë i ka ftuar edhe disa persona të tjerë prej të cilëve disa i kam njohur e disa jo dhe rreth orës 24:00 kanë shkuar disa musafirë dhe kemi mbetur unë, Fi, R dy vëllezërit S dhe një kamarier. Ka theksuar se vëllezërit S kane dalur nga lokali pa u përshëndetur dhe me një shpejtësi të madhe pas tyre ka shkuar dhe F, mandej bashkë me Min kur e kemi parë si dalje jo e zakonshme kemi thënë hajde dalim edhe ne të kqyrim se çka po ndodhë, kemi dalur jashtë dhe kemi parë në anën e majtë nga restoranti, përafërsisht 20 metra, afër zebrave ka qenë një veturë e kuqe, me markë S. A e parkuar. Aty i kam parë vëllezërit S

duke shkuar në drejtim të veturës, edhe unë dhe M. jemi nisur në atë drejtim. Për mos me ndërhy mes bisedës së vëllezërve S dhe dy personave që kanë qenë në veturë unë e kam pyet Fin se cka po ndodhë, i njëjti më është përgjigjur se nuk po e di saktë por ndoshta për ndonjë borxh dhe mua F mi ka kërkuar 50 euro borxh, të cilat ia kam jep menjëherë. Arsyen pse mi ka lyp Fi unë nuk e di. Në ato momente e kam dëgjuar emrin Arlind për sa më kujtohet e ka thirrë viktimën Ni. Gjithashtu është përmendur edhe arma- alltia. Viktimën Ni ka thënë pse po ma nxjerrë alltinë, bash saktë nuk mund ta përshkruajë se ka kaluar kohë e gjatë dhe gjithashtu kam dëgjuar edhe të shara mes vëllezërve S dhe personit që ishte në veturë (nuk më kujtohet saktë a kanë qenë të sharat nga dy personat në veturë apo vetëm nga njëri, mirëpo e di që ka pasur të shara nga të dyja anët). Unë nga vetura kam qenë larg përafërsisht 2 deri në 4 metra, ndërsa vëllezërit S kanë qenë shumë afër veturës ndoshta gjysme metre, ndërsa dy personat tjerë kanë qenë brenda në veturë e të cilët nuk i kam njohur. Pas të sharave vetura ka filluar të ec në drejtim të rr.”Luan Haradinaj” dhe vëllezërit S janë drejtuar drejt veturës së tyre e cila ishte përafërsisht 10 metra e parkuar nga aty, vetura ka qenë BMË, ngjyrë e zezë. Unë me M i kemi përshëndetur vëllezërit S, Fin dhe sa me kujtohet ka qenë edhe R. Bashkë me M ua kemi kthyer shpinën dhe kemi vazhduar me ec drejt veturës time e cila ka qenë e parkuar rreth 50 metra më lart, drejt rr. “Luan Haradinaj”. Në një moment përafërsisht 5-6 metra pasi që jemi larguar e kemi dëgjuar një veturë që ka ardhur dhe të shtëna të armës. Dhe jemi kthyer me fytyrë me kqyr se çka ndodhi. Ka qenë vetura e njëjtë Seat me ngjyrë të kuqe dhe një person në ulësen e pasagjerit i cili ka qenë me armë në dorë, dorën jashtë xhamit të veturës duke shti në drejtim të vëllezërve S e që ishin në një distancë shumë afër mes veturës Seat dhe vëllezërve S. Vetura Seat ka qenë në lëvizje dhe nuk është ndalur as kur ka gjuajtur. Vetura ka qenë me një shpejtësi mesatare. Herën e parë sa më kujtohet kanë qenë dy të shtëna. Pas të shtënave vetura ka vazhduar drejt rr.”Luan Haradinaj”, tek ish ndërtesa e OSBE-së, ka bërë gjysmërreth dhe është drejtuar prapë në drejtim të pompës IP petrol, ku pasagjeri ka qenë i ulur në dritare të veturës, me pjesën e lart të trupit jashtë veturës, ka pasur armën në dorë të drejtuar drejt vëllezërve S dhe ka gjuajtur përsëri në drejtim të tyre, pasi që armën e ka pasur në drejtim të tyre. Revolen e kam parë, e kam parë shkëndijën që ka dal nga tyta dhe aty e kam identifikuar se ka qenë revole, mirëpo ngjyrën se kam parë pasi që ka qenë natë. Vetura ka vazhduar në drejtim të IP petrol pa u ndalur ndërsa në ato momente e kam dëgjuar viktimën që ka thënë më plagosen. Kanë hyp shpejt në veturën BMË ngjyrë të zezë dhe janë nisur drejt spitalit Fi, dy vëllezërit S dhe R. Unë e kam telefonuar Fin për ta pyet se a ka nevojë për ndihmë, bashkë me Min kemi hypur në veturë dhe kemi shkuar në QKUK, ku jemi takuar edhe njëherë me Fin dhe e kemi pyetur edhe njëherë për ndonjë ndihmë financiare apo ndonjë ndihmë tjetër, më ka thënë jo, viktimën e kanë dërguar në QKUK dhe është shtrirë në emergjencë. Pastaj ne kemi vazhduar nga aty për në shtëpi.

Gjykata me kujdes të vecantë ka vlerësuar edhe dëshminë e këtij dëshmitari dhe të njëjtit ia ka falë besimin lidhur me faktin se natën kritike kishte qenë në kafiterinë “Francisko” e kjo deklaratë ndërlidhet edhe me deklaratat e dëshmitarëve të tjerë e posaçërisht me deklaratën e dëshmitarit M K, dhe përderisa kanë qenë duke festuar ditëlindjen e shokut të quajtur F së bashku me disa shokë të tjerë dhe derisa kanë qenë brenda në restorant ka parë vëllezërit S duke dalë nga lokali dhe pas tyre ka dalë dhe Fi dhe mandej kanë dalë të gjithë jashtë restorantit, ka ndëgjuar të shara mes personave në veturë dhe vëllezërve S dhe pastaj së bashku me Min janë larguar dhe kanë vazhduar me ec drejt veturës, por që pasi që janë larguar kanë dëgjuar të shtëna të armës dhe janë kthyer kanë parë se ka qenë e njëjta veturë Seat me ngjyrë të kuqe dhe një person në ulësen e pasagjerit i cili ka qenë me armë në dorë, dorën jashtë xhamit të veturës dukë shtënë në drejtim të vëllezërve S të cilët ishin në një distancë shumë afër veturës Seat dhe vëllezërve S, pas të shtënave vetura ka vazhduar drejt rrugës “Luan Haradinaj” ka bërë gjysmë rreth dhe është drejtuar prapë në drejtim të pompës IP petrol ku pasagjeri ka qenë i ulur në dritare të veturës me pjesën e trupit jashtë veturës ka pasur armën në dorë të drejtuar vëllezërve S dhe ka gjuajtur

përsëri në drejtim të tyre dhe në atë moment e ka dëgjuar viktimën duke thënë se “më plagosën”.
Fi, dy vëllezërit S dhe R kanë hipur në veturën BMË dhe kanë shkuar në QKUK.

Dëshmitari F.F në dëshminë e dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se: Me datë 23.11.2017 jemi dëgjuar me M.K të cilin e kam shok dhe e lam për me u taku për një darkë në restorant “Francesko”, që gjendet në rr.”Fehmi Agani”, në Prishtinë, ku jemi takuar rreth orës 18:00 ose 19:00 ku shkuam në restorant “Francesko” bashkë me vëllain P., aty na pritke L.K, aty u takuam për darkë, kur u afrua mesnata u dëgjova me disa shokë dhe pasi që pas orës 24:00 ishte ditëlindja ime i ftova disa prej shokëve me na u bashkangjitë siç janë N.S, B.S, R.K, B. B. dhe E. K.. Sa më kujtohet N ka ardhur i pari dhe ka qenë vet, pastaj B.dhe E. dhe pastaj nuk më kujtohet saktë a ka ardhur B. apo R përpara. Rreth orës 23:00 deri në orën 01:00 jemi kompletuar të gjithë. Persona tjerë në lokal nuk ka pasur përveç kamarierit dhe jemi ulur të gjithë së bashku. Unë kam pirë verë të kuqe ndërsa vëllezërit S nuk më kujtohet se çka kanë pirë. Nuk më kujtohet çfarë sasive është konsumuar aty mirëpo nga të gjithë unë kam qenë më i dehuri pasi që aty kam qenë nga ora 18:00 dhe nuk më kujtohet se si jemi ulur. Gjithashtu nuk më kujtohet pozita e vëllezërve S. Gjatë asaj kohe nuk kemi pasur ndonjë shqetësim apo lëvizje ku pastaj E. dhe B. kanë shkuar në shtëpi dhe nuk më kujtohet se gjatë kësaj periudhe ka ardhur dikush dhe është afruar tek tavolina jonë. Ka shtuar se B. ka dal nga lokali pastaj kemi dal unë dhe Ni e më vonë e kam parë që kanë dal edhe të tjerët Li, Mi dhe R, në rrugë e kam parë një automjet ngjyrë të kuqe apo të portokalltë në distancë prej 10-15 metra, Behari duke biseduar me pasagjerët brenda dhe nuk e di sa persona kanë qenë në veturë pasi që ka qenë terr dhe nuk kam mundur me pa, unë nuk kam mundur të dëgjojë se cka është biseduar aty mirëpo përshtypja ime është se aty në mënyrë shoqërore ka shkuar tek vetura, unë kam kërkuar nga Li 50 euro pasi që të njëjtët dolën jashtë ndërkohë dhe jam afruar nga ana e Beharit për me iu thënë nëse keni naj hall për pare mund të ua huazojë qito, mirëpo B. më ka shtyrë mos mu afri dhe unë jam tërheq, në ato momente makina është nisur me vrull për të lëviz në drejtim të udhëkryqit te ish Banka e Lublanës dhe N është nisur në atë drejtim mirëpo nëpër trotuar duke ecur pak më shpejt por jo vrap, pastaj e kam dëgjuar N duke e shajtur me nanë dhe duke thënë “Arlind kujt po ja nxjerrë alltinë”, jemi afruar unë dhe B. dhe e kemi kapur për krahu dhe jemi kthyer në drejtim të restorantit ku ka qenë edhe makina e vëllezërve S e cila ka qenë veturë BMË e zezë, seria një dhe kanë qenë shumë pak minutash sa ishim duke bisedu kur kam dëgjuar 2 deri 3 krisma. Ka shtuar se Behari është nisur në drejtim të makinës, unë u mendojsha me ndalu pasi që fitova përshtypje që don të niset pas tyre dhe ndërkohë tu u shty unë me B., Ni i qoj rrobat lart dhe tha më doket më kanë plagos, në atë moment e kemi hypur në makinë unë, B., R dhe Ni dhe kemi shkuar me shpejtësi në QKUK- emergjencë, dhe kur shkuam në emergjencë Ni ka qenë gjallë, dhe pasi që mjekët e pranuan Nin R më ka treguar që është plagosur.

Gjykata ka vlerësuar dëshminë e këtij dëshmitari, dëshmi të cilën e ka vlerësuar si plotësisht të sinqert, reale dhe objektive, e nga e cila ka vërtetuar bindshëm faktin se natën kritike i njëjti ka festuar ditëlindjen në restorantin “Francisko” në rrugën “Fehmi Agani” në Prishtinë, së bashku me tani të ndjerin N.Sn, B.Sn, dhe disa shokë të tjerë, ku pas një kohe B. ka dal nga lokali dhe kane dal dhe ai vet dhe Ni, e pak më vonë kanë dal edhe të tjerët L, M dhe R, me çrast në rrugë ka parë një automjet me ngjyrë të kuqe ka pohuar se ka parë B. duke biseduar me pasagjerët ka dëgjuar N duhe e shajtë me nanë duke thënë”A. kujt po ja nxjerrë alltinë” pastaj i njëjti së bashku me B. janë afruar e kanë kapur për krahu Nin dhe janë kthyer në drejtim të restorantit kur i njëjti ka theksuar se ka dëgjuar 2 ose 3 krisma me çrast Ni i ka qar rrobat lart dhe ka thënë se mduket se jam plagos, në ato momente e kanë hypur në makinë së bashku me B., dhe R. dhe janë nisur me shpejtësi për në QKUK-emergjencë, dhe pasi që mjekët e kanë pranuar N, R i ka treguar se është plagosur.

E dëmtuara dëshmitarja R.K në dëshminë e dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se: Kam marrë pjesë në festimin e ditëlindjes së Fit mes natës 23.11.2017 dhe 24.11.2017, orën nuk e di por e di që ka qenë lokali “Francisko” dhe aty e kam njohur vetëm Fin ndërsa personat tjerë nuk i kam njohur por me sa më kujtohet kanë qenë 5 ose 6 persona. Ka shtuar se më kujtohet kur ka dal i pari Ni nga lokali pastaj ka dalur vëllai i tij, pastaj Fi mandej kanë dalur krejt dhe unë mbeta vet në lokal dhe pas disa minutash kam dalur edhe unë nga lokali pasi dëgjova disa zhurma dhe në anën e majtë të derës së lokalit ka qenë një makinë e BMË e zezë, në pjesën e përparme të BMË ka qenë Fi, Ni dhe Behari në anën e djathtë afër kanë qenë edhe dy persona tjerë që kanë qenë brenda në lokal. Ka theksuar se pasi u afrova tek makina pasi ishte aty Fi aty me shpinë prej rrugës dhe brenda 5 sekondave kanë gjuajtë me arm, nuk e di sa gjuajtje kanë qenë dhe nuk e di se sa kanë qenë larg momenti kur kanë gjuajtur me armë, dhe nuk e di të shtënat a kanë qenë të njëpasnjëshme apo pas një kohe të caktuar. Ka shtuar se pasi që u ndalën të krisurat Behari ka pyet se a jeni mirë, në fillim krejt kemi thënë po dhe mandej i ndjeri Ni e ka vërejtur që nuk është mirë, e ka qit dorën tek plaga dhe mandej e ka ngritur maicën me na tregu, mandej e kam vërejtur edhe unë plagën time, pasi që më ka ardhur me i shtrëngu duart dhe e kam pa që dorën e majtë nuk mundem me shtrëngu, konkretisht gishtat dhe aty e kam vërejtur plagën në gishtin e tretë të dorës së majtë dhe gishtit është jofunksional. Pasi që Ni ua tregoi plagën Ni hypi në veturën BMË të zezë dhe shkuam në emërgjencë ku jam kontrolluar edhe unë dhe tash kam probleme me gisht, Ni rrugës ka qenë gjallë.

Gjykata ka vlerësuar edhe dëshminë e kësaj të dëmtuare-dëshmitare, të cilën dëshmi e ka gjetur si dëshmi të sinqertë dhe objektive, meqenëse e njëjta është në përputhje edhe me deklaratat që kjo dëshmitare ka dhënë në deklaratimet e saja të mëparshme lidhur me këtë çështje penale, e po ashtu edhe me provat materiale të administruara në këtë çështje penale, siq janë mendimi i ekspertit mjekoligjor Dr.Arsim Gërxhaliu për të dëmtuarën R.K ku konstatohet Dëmtim nga arma e zjarrit, Fracture, Amputim i pjesës distale të gishtit të tretë të dorës së majtë si dhe nga mendimi i ekspertit të balistikës kriminalistike Hazir Kelmendi, i datës 16.02.2018, dëshmi e cila ka vërtetuar bindshëm, faktin se natën kritike deri sa kanë qenë në lokalin ‘Francisko’ duke festuar ditëlindjen e F.ku kanë qenë prezent dhe 5 ose 6 persona të tjerë, Ni ka dal nga lokali mandej pas tij kanë dal F. dhe të tjerët dhe pastaj ka dalë dhe vet nga lokali dhe deri sa e njëjta është ofruar afër Fit ka dëgjuar gjuajtje me armë dhe pasi janë ndalë krismat B. i ka pyetur se a jeni mirë mandej i ndjeri Ni e ka vërejt se nuk është mirë dhe e ka ngrit maicën me ju tregu plagën, pastaj e njëjta ka vërejtur se dorën e majtë nuk ka mundur me shtrëngu ku dhe ka vërejtur plagën në gishtin e tretë të dorës së majtë i cili është jofunksional dhe të njëjtit kanë shkuar në emërgjencë me veturën BMË e zezë.

Shqyrtimi gjyqësor lidhur me këtë çështje penale ka vazhduar me dëgjimin e ekspertit mjeko ligjor dr.Arsim Gërxhaliu i cili në seancën e datës 08.11.2022 ka deklaruar se: Mbetem pranë raportit të përpiluar, në aspektin mjeko ligjor kur kemi të bëjmë me armët e vogla që mbahen me dorë i kemi dy kualifikime nga afërsia dhe largësia, që largësia nënkupton gjatësia në mes plagës dhe tytës së armës apo ardhjes së atij drejtimi të predhës e që është mbi 1 metër nën 1 metër është afërsi. Ka theksuar se kur kemi kryer obduksionin e trupi të pajetë ka pasur një vrimë, plagë shkuese (kur predha mbetet në brendësi të organizmit), predha është gjendur në brendësi të organizmit, ajo ka qenë e shkatërruar dhe një pjesë është gjetur edhe tek mëlqia, zakonisht predha mund të shkatërrohet edhe tek pjesët e forta kockore por mund edhe të shkatërrohet- dëmtohet gjatë rrugëtimit nga tyta deri në organizëm, në rastin konkret ajo është dukshëm e dëmtuar, që do të thotë se dëmtimi i saj mund të ketë ndodhur jashtë organizmit. Ka theksuar se trajektorja e predhës që ka mbetur në organizëm ka hyrë nga ana e pasme e jashtme, e majtë në organizëm dhe pasi që ka hyrë në organizëm drejtimin e ka prej poshtë-lart, para djathtas tek bronku u mushkërive ku kapen dy mushkëritë, pozicioni i të ndjerit kur ka marrë plagën bazuar nga

rrethanat mund të supozohet që është një rikoshe jashtë organizmit meqenëse predha shkon nga poshtë-lart dhe djathtas dhe meqenëse nuk kemi dëmtime tjera që mund të jetë i rrëzuar, andaj nuk përjashtohet mundësia që mund te ketë qenë në këmbë dhe predha të vijë nga pozicioni i pasëm.

Në pyetjen e trupit gjykues se predha e cila është gjetur në trupin e të ndjerit N a është shkaktar i vdekjes së të njëjtit, eksperti ka deklaruar se: Po është shkaktar i vdekjes sepse ka prekur bazat me rëndësi vitale të arteries pulmonare menjëherë pas daljes prej zembrës dhe për shkak të gjakderdhjes së brendshme 600 ml i kemi gjetur gjak në kafazin e kraharorit dhe 400ml i kemi gjetur brenda përbrenda qeskës së zembrës.

Përgjatë këtij shqyrtimi gjyqësor gjykata me pëlqimin e palëve ka aprovuar propozimin e prokurorit që të lexohet deklarata e të dëmtuarit-dëshmitarit M K dhënë në polici me datë 24.11.2017 për shkak se i njëjti gjendet jashtë vendit dhe nuk ka mundur të prezantojë në shqyrtim gjyqësor.

Ndërsa prokurori është tërhequr nga propozimi që të dëgjohet në cilësinë e ekspertit Hazir Kelmendi pasi që nga i njëjti është pranuar raporti me shkrim për të cilën raport ka deklaruar se nuk ka vërejtje.

I dëmtuari-dëshmitari M K në deklaratën e dhënë në polici me datë 24.11.2017 ka deklaruar se: Me datë 23.11.2017 kam qenë i ftuar nga shoku im L.K në një darkë në restaurantin e tij “Francisko” dhe në ora 21:00 jemi takuar në restaurant dhe aty kemi qëndruar së bashku me Lin dhe disa shokë të tjerë si P. F., F F. kemi ngrënë dhe kemi bërë muhabet shoqëror, ka ora 23:00 kemi dashtë me përfundu ndejën ë kësaj darke por F F. na tha që e ka ditëlindjen me dt.24.11.2017 dhe na ftoi që të rrimë edhe pak dhe ta festojmë ditëlindjen e Fit. Ka theksuar se Fi i ftoi edhe disa shokë të tij dhe për ne nuk pati problem shoqëria më e gjerë sepse ishte në pyetje festa e ditëlindjes së tij, pas pak rreth orës 23:15 erdhi personi N.S e ndërkohë erdhën edhe dy persona tjerë B. B. dhe L. U., më vonë ka ardh edhe B.S me një vajzë. Ka theksuar se N.Sn, B.Sn dhe atë vajzën që kanë qenë në dark nuk i kam njohur dhe ka qenë hera e parë që i kam takuar në ditëlindjen e Fit. Pas orës 01:30 të datës 24.11.2017 personat që kanë qenë në tavolinë me ne si F F., L.K, N.S, B.S dhe një vajzë nuk ja di emrin jan qu nga tavolina, ka shtuar se edhe meë herët B.S dhe N.S kanë dalë jashtë dhe kanë biseduar me telefon të cilën nuk e di arsyen, dhe kur përfundoi kjo festë jashtë lokalit në rrugë kemi dëgjuar disa zëra me tone të larta dhe unë së bashku me Lin kemi dalu për të shikuar qka është në pyetje dhe aty jashtë afër rrugës kam vërejtur një veture me ngjyrë të kuqe, S., dy persona mbrenda veturës dhe këta vëllezërit duke folur me ta. Ka shtuar se në atë kohë janë ndëgjuar fjalë fyese nga N.S duke i thënë personit që ishte në veturën S. “A. ka me ta qi familjen” dhe ata janë larguar, por ndërkohë shumë shpejt janë kthyer të njëjtit me veturën S. dhe nga vetura përmes dritares kanë gjuajtur me armë dy herë në drejtim të vëllezërve N dhe B.S, vetura ka gjuajtur me armë në lëvizje dhe është larguar por prap pas një kohe të shkurtër është kthyer ka bërë gjysmërreth te objekti ish prokurorisë dhe pasi është kthyer përsëri ka gjuajtur me armë një herë në drejtim të vëllezërve dhe me shpejtësi janë larguar në drejtim të kafeve të vogla do të thotë në drejtim nga ambasada e Kroacisë. Ka shtuar se të gjitha gjuajtjet me armë i kam pa që janë gjuajtur nga pasagjeri do të thotë dy gjuajtjet e para janë bërë afër dy vëllezërve ndërsa gjuajtja tjetër është pasi janë kthyer nga gjysmë rrethi duke dalur pasagjeri jashtë dritares i ulur në dritare dhe e kam pa gjuajtjen ka shtënë një herë. Personat që kanë qenë në veturën S. nuk i njohë vetëm se e kam dëgjuar nga N.S duke i sharë duke i përmendur emrin A. sgjë nuk di më shumë për ta.

Gjykata me kujdes të vecantë ka vlerësuar edhe dëshminë e këtij dëshmitari dhe të njëjtit ia ka falë besimin lidhur me faktin se natën kritike kishte qenë në kafiterinë “Francisko” e kjo deklaratë

ndërlidhet edhe me deklaratat e dëshmitarëve të tjerë dhe provave materiale të administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Trupi gjykues lidhur me këtë çështje penale ka bërë administrimin e të gjitha provave materiale dhe atë nga prova materiale – Raporti i Autopsisë Ma17-319 nga eksperti mjekoligjor Dr.Arsim Gërzhaliu për të ndjerin N.S është konstatuar se: vdekja e të ndjerit N.S ka ardhë si pasojë e Tamponadës së zemrës të shkaktuar nga dëmtimi traumatik i arteries pulmonare e cila ka ardhë si pasojë e plagëve me armë zjarri në krahëror, plaga nga arma e zjarrit ka karakteristikat e plagës së shkaktuar nga largësia.

Po ashtu nga mendimi i ekspertit mjekoligjor Dr.Arsim Gërzhaliu për të dëmtuarën R.K konstatohet se: Dëmtim nga arma e zjarrit, Fracture, Amputim i pjesës distale të gishtit të tretë të dorës së majtë, natyra e dëmtimeve të tilla në bazë të dokumentacionit mjekësor present dhe ekzaminimit objektiv kualifikohet në Dëmtim të rëndë trupor e shoqëruar me dëmtim të përhershëm të shëndetit, dëmtimet konsistojnë me të dhënat në lëndë të jenë fituar nga veprimi i energjisë kinetike të liruar nga predha e njëjta e liruar nga arma e zjarrit.

Nga mendimi i ekspertit të balistikës kriminalistike Hazir Kelmendi, i datës 16.02.2018 është konstatuar se e tërë ngjarja është zhvilluar në mes të personave të pandehur, viktimës dhe të dëmtuarit dhe atë në pjesën e rrugës dhe trotuarit para kafiterisë “Franciska” rreth orës 02:30 ku dhe kanë mbetë gjurmët e mjeteve të përdorura dhe ato me prejardhje të pandehurve nga viktima dhe personi i dëmtuar. Nga raporti i shikimit të vendit të ngjarjes shifet se në mes të rrugës Fehmi agani përballë lokalit “Gresa” është gjetur një gëzhojë e kalibrit 7.62 e shënuar me VN-1, po në këtë pjesë në asfalt përballë lokalit “Franciska” është gjetur një pjesë e dëmtuar e sftalit e që dyshohet se e ka prejardhjen nga predha e shënuar me VN-2. Me VN-3 është gjetur një gëzhojë në trotuarnë anën perëndimore përballë lokalit Bar ACA, me VN-4 është evidentu edhe një dëmtim tjetër në asfalt e që dyshohet të jetë nga predha dhe atë përballë lokalit “Cornea Optic”, me VN-5 është identifiku një njollë e kuqe e cila gjindet në trotuar përballë lokalit “Travel Plus” e shënuar me VN-6, një njollë e kuqe e shënuar me VN-7 është gjetur në trotuarin e rrugës “Fehmi Agani” përballë lokalit “Travel Plus”, VN-8 është gjetur një gëzhojë e fishekut në mes të rrugës “Fehmi Agani” përballë lokalit “Turkish Airlines”, fragment metali (Këmishë predhë) e gjetur në trotuar përballë lokalit “Julius Meint” në terasë në rrugën “Fehmi Agani” shënuar me VN-9, dëmtimi i shkaktuar nga predha në trungun dekorues përballë lokalit “Cornea Optica” është shënuar me VN-10. Automjeti me të cilin kanë ardhur tani i pandehuri A.A dhe A.V ka ardhë në rrugën Fehmi Agani i drejtuar në drejtim të pompës së derivateve “Ip Kos” është ndalur afër trotuarit në rrugën “Fehmi Agani” dhe është zhvilluar një bisedë e ashpër në mes të vozitësit të automjetit A.At dhe tani të ndjerit N. Është bërë krahasimi i shpjegimeve që i ka dhënë vëllau i viktimës, pastaj L.K, R C., B.S etj, krahasimi i gjurmëve të gjetura në vendin e ngjarjes, karakteristikat e këtyre gjurmëve dhe prejardhjen e tyre mund të konstatohet se: Natën kritike sipas raportit të balistikës është përdorur pistoleta e markës TT prodhim Rus, kalibër 7.62x25 mm nga e cila janë zbrazë 3 gëzhoja të të njëjtit kalibër dhe ato gëzhoja janë gjetur në mes të rrugës, në trotuar dhe e treta prapë në rrugë. Në rrugë është gjetur edhe një këmishë predhë pa karakteristika për identifikim të saj, nga kjo armë besohet se ka mbet edhe pjesët e dëmtuara në asfalt të shënuara me VN-2 dhe VN-4, edhe dëmtimi në tregun dekorues përballë lokalit “Cornea Optica” me besueshmëri është mbet nga predha e zbratur nga kjo pistoletë. Ka theksuar se nga karakteristikat e pistoletës shihet se natën kritike është përdorur një pistoletë e cila ka karakteristika të shkëlqyeshme me shpejtësi i afrohet pistoletave automatike dhe mu për atë bëhet edhe lidhmëria e dëmtimeve në asfalt, këmishës së mbetur në vendin e ngjarjes dhe predhës së nxjerrur nga viktima gjatë autopsisë. Personi që ka shti me pistoletë e ka patur dorën në kornizën e dritares së hapur dhe ka shtënë në një distancë më të madhe me siguri se 1 metër dhe atë sipas

karakteristikave që i ka lënë predhat në asfalt këndi i të shtënave gjegjësisht dora ka qenë në një kënd më të vogël se 70 shkallë dhe me këtë rast gëzhoja është hedhur në anën e djathtë në një kënd prej më shumë se 90 shkallë, ka has në automjet dhe ka mbet në asfalt, ndërsa predha ka rënë në asfalt, e ka ndërruar trajektoren dhe në këndin e ramjes e kemi edhe këndin e ngritjes kështu që predha e rikoshetuar nga asfalti e ka goditur tani të ndjerin në një largësi të ngritjes në 130 cm vrima hyrëse, kjo predhë është dëmtuar në pjesën e poshtme pasi që ka ikur nga maja dhe me trup i ka rënë asfaltit, e ka humb energjinë e ka godit viktimën dhe ka mbet në trupin e viktimës, edhe dëmtimi i dytë në asfalt është shkaktuar pothuajse sikurse i pari është hequr këmisha prej pjesës së plumbit dhe tani kemi 2 pjesë fluturuese, këmishën dhe bërthamën e projektilit, ku njëra prej tyre e ka goditur në gishtin e dorës së majtë tani të dëmtuarën R Curri ndërsa tjetra ka mbet në asfalt. Tutje ka theksuar se tani i ndjeri N.S ka marr plagë vdekjeprurëse nga personi i cili ka shti me armë zjarri me besueshmëri të madhe nga automjeti në lëvizje me dritare të hapur të ngadalësuar në anën e djathtë të rrugës ku predha ka has në bazë të fortë asfalt, është rikoshetu dhe këndi i ngritjes së predhës kah rruga e saj ka goditur të ndjerin N.Sn në 1 metër e 30 cm nga thembra nën shpatullën e majtë, edhe e dëmtuara R Curri ka pësuar plagë në dorën e majtë në gishtin e mesëm më besueshmëri nga rikoshetimi i predhës së dytë e cila është dëmtuar tërësisht, një pjesë e këmishes ka mbet në asfalt dhe një pjesë e projektilit e ka goditur tani të dëmtuarën.

Nga raporti i ekspertimit të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë AKF/2018-0104/2018-99 i datës 24.01.2018, me të cilat është kryer ekzaminimi daktiloskopik i dëshmimeve vërtetohet se në të njëjtin është konstatuar se gjurma e vijave papilare me inicialen F#1 (gjurmë e vijave papilare shuplakore) është krahasuar –eliminuar me shuplakat e duarve të viktimës N.S ku është konstatuar se nuk i takon (nuk i përket). Gjurma e vijave papilare shuplakore me inicialen F#1 e nxitur, të tërhequr me shirit ngjitëse transparente në kazanin e ujit të sholës së banjës në dhomën e hotelit numër 50 “Villa Queens” te “QMI”, K.K Gracanica me datë 24.11.2017 ora 21:25, me numër rasti të hetuesisë 2017-AB-3662, pas skanimit në sistemin kompjuterik të “CAFIS”-it “LPDB” (bazë e të dhënave të gjurmëve latente shuplakore) ka dhënë rezultat (përputhshmëri) me shenjën e shuplakës të dorës së majtë (pjesa hipotenare) të personit të dyshimtë A.V me dtl.23.09.1987. Identifikimi i gjurmës së vijave papilare me inicialen F#1 është punuar në mënyrë tabelore në sistemin kompjuterik “Cafis” më shenjën e shuplakës së dorës të majtë të personit A.V të skanuar (regjistruar) në sistemin kompjuterik të “CAFIS” me numër KS024989R ku edhe i njëjti konstatim është vërtetuar edhe me krahasimin manual me anë të “Llupave”.

Nga raporti i ekspertimit të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë AKF/2018-0104/2018-98 i datës 25.01.2018, vërtetohet se në të njëjtin është konstatuar se nga dëshmitë e dorëzuara HP#18 janë:

- Një (1) pistoletë e gasit “Ekol Special 99” e kalibrit 9 mm gas me numër serik “EV-1612999” e cila është ridizajnuar (duke ju vendosur një tyt me vjaska, e punuar me dorë) në mënyrë që të shkrepë fishekë të kalibrit 7.65x17mm me mbushje të barotit dhe në këtë mënyrë arma është bërë armë e zjarrit, arma është funksionale.
- Një (1) karikator i zbazët me kapacitet prej tetë (8) fishekëve të kalibrit 9 mm i dizajnuar për pistoletë “Ekol Special 99” të kalibrit 9 mm gas. Dëshmitë e dorëzuara HP#18 dhe HP#20.1 janë të tëmbëdhjetë (18) fishekë të kalibrit 7.65x17mm, nuk është zbuluar përpuethshmëri me raste të tjera të Librarisë së rasteve të hapura.

Nga raporti i ekspertimit të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë AKF/2018-0008 e datës 23.01.2018, me rastin e analizimit dhe identifikimit të mbetjeve të grimcave të barotit (GSR) nga kapsolla inicuese pas qitjes me armë të zjarrit përmes metodës me mikroskop elektronik skanues (SEM/EDS) nr.PRT-7.7 vërtetohet se në të njëjtin është konstatuar se në tubin (diskun) objekt ekspertimi nga dëshmitë #1 dhe #2 nuk u evidentuan mikrogrimca unike me përmbajtje të tre elementeve kimik me prejardhje nga kapsolla e armës së zjarrit.

Nga raporti i ekspertimit të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë AKF/2018-0008 e datës 26.01.2018, nga ekzaminimi i pajisjes elektronike vërtetohet se në të njëjtin është konstatuar se dëshmia HP#10.1 telefon samsung IMEI 353135058795920 me SIM kartelë Z-mobile 8937701010057960771, HP#20.1 telefon Nokia IMEI 357295084584684, janë ekzaminuar dhe procesi i ekzaminimit ka rezultuar me gjetjen e të dhënave si në vijim: kontaktet dhe SMS mesazhet. Dëshmia HP#20.1 SIM kartelë IPKO nuk ka mundur të ekzaminohet sepse ka pasur PIN kod të panjohur. Rezultatet e ekzaminimit lidhur me këtë rast janë pjesë e raportit të kopjuar në dy DVD në dosjen AKF-2018-0008 Raporti Final.

Nga fotoalbumi i vendit të ngjarjes i Policisë së Kosovës-Njesia e Forenzikës, vërtetohet se fotografit në kuadër të njëjtit paraqitet vendi ku ka ndodhur ngjarja, dëshmit e evidentuara dhe vendi ku janë evidentuar, në foton nr.1 është evidentuar një gëzhgjë fisheku e cila ishte në mes të rrugës “Fehmi Agani” përballë lokalit “Gresa”, në foton nr.2 është evidentuar dëmtimi i asfaltit, në foton nr.3 është evidentuar një gëzhgjë fisheku që ishte në trotuarin e anës jugperëndimore të rrugës përballë lokalit “ACA”, në foton nr.5 dhe foton nr.6 janë evidentuar njolla të kuqe të ngjashme me gjak përballë lokalit “Travel Plus”, në foton nr.8 është evidentuar një gëzhgjë e fishekut përballë lokalit “Turkish Airlines” si dhe foto të tjera të evidentuar me dëmtime të rrugës, po ashtu dhe fotot e tjera të bashkëngjitura në shkresat e lëndës evidentojnë veturën S. më ngjyrë të kuqe me targa 01-936-JN.

Trupi gjykues në seancën e datës 02.12.2022 ka vazhduar me shikimin e videoincizimit marrë nga lokali “Optika”, të cilën video e ka elaboruar prokurori i shtetit duke theksuar se: Videoincizimet janë marrë me datë 24.11.2017, në periudhën kohore nga ora 01:00:12 dhe ngjarja zhvillohet deri në orën 01:52 sipas kohës si videoincizimit.

Në ora 01:28:40 një person me telefon në dorë del nga lokali “Francisko” dhe duke biseduar në telefon shihen disa drita të automjetit duke blinduar dhe pastaj një veturë shkon tek personi që është para lokalit “Francisko”, ku ndalet vetura dhe personi me telefon hyn në veturën S. dhe ky person besohet që është tani i ndjeri, dhe vetura largohet nga aty dhe e njëjta veturë kthehet në ora 01:33:54.

Në ora 01:34:52 i njëjti person del nga vetura dhe hyn në lokalin “Francisko” ndërsa vetura largohet nga aty.

Në ora 01:41:01 dyshohet se i njëjti person del prapë nga lokali “Francisko” dhe kalon në pjesën tjetër të rrugës ku dyshohet që është prapë vetura e njëjtë dhe i njëjti hyn në veturë në ulësen e pasme dhe vetura largohet nga aty.

Në ora 01:48:50 dy persona dalin nga lokali “Francisko” dhe të njëjtit kthehen në anën e majtë dhe vijnë afër një veturë të cilat i ndezin dritat anësore me anë të çelësit dhe pas disa sekondash del edhe një person tjetër nga lokali “Francisko” i cili vazhdon në të njëjtën anë dhe i njëjti ka në dorë e majtë një dritë apo telefon të ndezur.

Në ora 01:49:26 pranë veturës vjen e njëjta veturë S. ku në këto momente dy persona dalin nga lokali “Francisko” dhe një person i cili ka dal më herët nga lokali “Francisko” shkon tek vetura S. tek ana e djathtë tek pasagjeri, ndërsa në anën e majtë të veturës shkon personi tjetër i cili në momentin kur ka dal nga lokali “Francisko” ka pasur një dritë apo telefon në dorë, e njëjta dritë-telefon i shihet edhe kur afrohet tek vetura, ndërsa tre persona tjerë qëndrojnë në trotuar ku shihet se bisedojnë dhe më pas njëri nga ata afrohet tek vetura Seat tek pjesa e pasagjerit dhe në këto momente shihet kur personi i cili është në anën e majtë të veturës duke u larguar, gjithashtu në këto momente shihet se vetura nis me vrull, ndërsa personi që ka qenë nga pjesa e djathtë e veturës shihet sikur vazhdon drejtë veturës dhe personi tjetër që është afruar të njëjtin tenton ta ndalojë.

Në minutën 01:50:09 shihen vetura e cila është përballë lokalit “Francisko”, një person i cili pjesën e jashtme të trupit e ka jashtë veturës ndërsa katër persona tjerë gjenden përballë lokalit “Optika” dhe e njëjta veturë duke lëvizur vazhdon dhe largohet nga aty ndërsa njëri person në pjesën e trotuarit nga lokali “Optika” vazhdon për tek lokali “Francisko” dhe prapë i njëjti kthehet nga pjesa e lokalit “Optika” ku kanë qenë edhe personat tjerë dhe shihet se tre persona afrohen afër njëri tjetrit, ku është një lloj shtyrje mes veti mes tre personash, pastaj aty afrohen edhe dy persona tjerë dhe tre personat vazhdojnë prapë nga lokali “Optika”, të cilët janë të kapur përdore. Në min 01:50:45 dalin nga pjesa ku nuk e kap kamera dhe nuk shihen, ndërsa një person qëndron në mes të trotuarit dhe në këtë moment nga lokali “Francisko” del e dëmtuara R.K. Gjithashtu afër lokalit “Francisko” është edhe një person tjetër dhe e dëmtuara R vazhdon në drejtim të veturës e cila ka qenë e parkuar dhe në këtë moment ndezën dritat, ku kjo veturë shihet vetëm pak në kamerë, dhe e njëjta vazhdon nga pjesa e majtë e veturës dhe e njëjta nuk shihet se nga shkon. Në këto momente shihet se prapë e dëmtuara R kthehet përballë lokalit “Optika” dhe e njëjta dorën e majtë e mban përpara në gjoks ku dyshohet se është e plagosur në atë moment. Pastaj kthehet nga trotuari dhe prapë del nga pjesa ku nuk e kap kamera, ndërsa dy personat që kanë qëndruar në trotuar futen brenda në lokalin “Francisko”. Në minutën 01:51:30 shihet se e njëjta veturë me një shpejtësi më të madhe kalon pranë lokalit “Francisko”. Në minutën 01:51:46 vetura S. prapë kthehet mirëpo vetëm është në anën e kundërt të rrugës dhe në këto momente të dëmtuarit gjenden jashtë pjesës ku është e mbuluar me kamera afër veturës së tyre. Në minutën 01:51:58 shihet vetura e cila ka qenë e parkuar se e njëjta fillon të lëviz duke u kthyer në pjesën tjetër, e njëjta ndalet në rrugë, hapin dyert e veturës, i mbyllin dyert dhe vazhdon duke u larguar nga vendi i ngjarjes.

Mbrojtësi i të pandehurit A.A Av.Asdren Hoxha ne seancën e dt.02.12.2022 i ka propozuar gjykatës që në cilësi të provës materiale të administroj raportin përcjellës të policisë së Kosovës të datës 25.01.2018, në formë të memorandumit zyrtar, i cili është lëshuar në bazë të urdhresës së Prokurorisë, përkatësisht gjykatës, e që përmban transkriptet e bisedave telefonike të bashkangjitura këtij raporti të shkruara me fjalë prej 1 deri në 18 faqe, duke filluar prej datës 24.11.2017, nga ora 01:23:15 deri me datën 24.11.2017, në ora 02:39:47, e që kjo provë përmban transkriptet telefonike të bisedave të përgjuara ligjërisht mes të mbrojturit tim A.A të zhvilluara disa herë me të ndjerin N.S por edhe me vëllain e tij B.S, si dhe me një person të gjinisë femërore të quajtur L. apo B. siç është cekur në transkriptë. Kjo provë është marrë nga prokuroria me rastin e marrjes së shkresave të lëndës dhe është përdorur nga mbrojtja gjatë ekzaminimit të dëshmitarit B.S. Dhe fundja ka rëndësi dhe lidhmëri me gjendjen e kësaj çështje dhe mendoj që është e rëndësishme për të vërtetuar të vërtetën dhe gjendjen e drejtë faktike sidomos për faktin se disa herë është thirrë i mbrojturi im nga vëllezërit S me theks të veçantë është thirrë të kthehet në atë vend për herë të fundit.

Gjykata ka aprovuar propozimin e mbrojtësit Av.Asdren Hoxha dhe si provë materiale është administruar raporti përcjellës i policisë së Kosovës, Njësisë hetimeve me nr.reference 06/2-02/162/15 i datës 25.01.2018 si dhe transkriptet e bisedave të shkruara me fjalë në 18 faqe.

Gjakata ka vlerësuar dhe raportin përcjellës Njësisë hetimeve me nr.reference 06/2-02/162/15 i datës 25.01.2018 si dhe transkriptet e bisedave të shkruara me fjalë në 18 faqe, trupi gjykues nuk ju fali besimin pasi që në transkript shifet se i pandehuri Arlind bisedon me persona N.N dhe përmendet emri B. dhe flasin për goditjen me plumbë të të ndjerit N, për gjaktatë transkriptet e bisedave të shkruara me fjalë në 18 faqe nuk vërteton ndonjë gjë të caktatu sa i përket objektk të kësaj qeshtje penale.

Trupi gjykues ka refuzuar propozimin e mbrojtësit të pandehurit A.V Av. Florent Latifaj për marrjen e provës nga ana e Institutit të Mjekësisë ligjore, nga mostrat e marra nga i ndjeri N.S nëse i njëjti ka konsumuar në natën kritike substanca narkotike apo alkool, pasi që gjykata ka vlerësuar se kjo provë nuk ka të bëjë me objektin e aktakuzës dhe po të vërtetohej nëse i ndjeri ka konsumuar drogë apo alkool prapë e njëjta nuk do të kishte asnjë relevancë lidhur me çështjen. Sipas nenit 143 par.2 të KPPRK-së, rezulton se vetëm në raste kur dyshohet për helmim autorizohet kryerja e ekspertizës toksikologjike, çka në rastin konkret nuk ka ndollur te i ndjeri. Pasi që bazuar edhe nga Raporti i Autopsisë Ma17-319 nga eksperti mjekoligjor Dr.Arsim Gërxhaliu për të ndjerin, ku është konstatuar se: vdekja e të ndjerit N ka ardhë si pasojë e Tamponadës së zemrës të shkaktuar nga dëmtimi traumatik i arteries pulmonare e cila ka ardhë si pasojë e plagëve me armë zjarri në krahëror.

Vlerësimi i gjykatës:

Gjykata duke vlerësuar të gjitha provat një nga një dhe të gjitha së bashku, në përputhje me nenin 361 të KPPRK-së, për veprat penale si në dispozitivin e aktakuzës ka vërtetuar gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Faktet jo kontestuese:

Nga të gjitha këto prova të administruara, për gjykatën nuk ishte kontestuese se me datë 24.11.2017 i akuzuarit A.A pas një fjalosje me tani të ndjerin N.Sn në rrugën “Fehmi Agani” pranë kafiterisë “Francisko”, është larguar nga vendi i ngjarjes me veturën e tipit “S.” ngjyrë e kuqe me targa 01-936JN dhe është kthyer prapë së bashku me të akuzuarin A.V.

Gjithashtu nuk ishte kontestuese as fakti se natën kritike në vendin e ngjarjes kanë qenë prezent edhe dëshmitarët B.S, L.K, F.F, R.K dhe M K të cilët ishin duke e festuar ditëlindjen e Fit në kafiterinë “Francisko”.

Po ashtu për gjykatën nuk ishte kontestuese se nga vetura “S.”, deri sa ka qenë në lëvizje ka pas të shtëna me armë zjarri, me çrast nga këto të shtëna është privuar nga jeta tani i ndjeri N.S, këto fakte janë vërtetuar edhe nga dëshmitë e të dëmtuarve dhe deklaratat e mbrojtësve të akuzuarve. Se N.S është privuar nga jeta nga plagët e marra nga shkrepija e armës Revole e tipit TT me numër serik XB 23930945, e kjo është konstatuar edhe nga Raporti i Autopsisë Ma17-319 nga eksperti mjekoligjor Dr.Arsim Gërxhaliu për të ndjerin, ku është konstatuar se: vdekja e të ndjerit N ka ardhë si pasojë e Tamponadës së zemrës të shkaktuar nga dëmtimi traumatik i arteries pulmonare e cila ka ardhë si pasojë e plagëve me armë zjarri në krahëror.

Gjithashtu nuk ishte kontestuese se e dëmtuara R.K natën kritike ka pësuar lëndime në gishtin e mesëm të dorës së majtë, të cilat lëndimet janë konstatuar nga mendimi i ekspertit mjekoligjor Dr.Arsim Gërxhaliu ku për të dëmtuarën R.K konstatohet se: Dëmtim nga arma e zjarrit, Fracture, Amputim i pjesës distale të gishtit të tretë të dorës së majtë, natyra e dëmtimeve të tilla në bazë të dokumentacionit mjekësor present dhe ekzaminimit objektiv kualifikohet në Dëmtim të rëndë trupor e shoqëruar me dëmtim të përhershëm të shëndetit, dëmtimet konsistojnë me të dhënat në lëndë të jenë fituar nga veprimi i energjisë kinetike të liruar nga predha e njëjta e liruar nga arma e zjarrit.

Fakt i pakontestueshëm ka qenë edhe fakti se i akuzuari A.A pa autorizim nga data e pacaktuar e deri me datën 25.11.2017, ka poseduar armën me numër serik XB 23930945 e kalibrit 7.62 mm prodhim rus, me një karikator dhe 8 fishekë si dhe revolen e tipit Ecol Special, e kalibrit 9 mm PAK, me numër serik EV16120999 me një karikator, me 7 fishekë si dhe 12 fishekë tjerë të

kalibrit 7.35 mm, në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët, e ky fakt nuk është kundërshtuar as nga vet i pandehuri dhe mbrojtësi i tij, ku i pandehuri në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 19.11.2021 e ka pranuar fajësinë sa i përket pikës II të dispozitivit të aktakuzës.

Faktet e lartcekura nuk kanë qenë kontestuese në mes të palëve. Përveç kësaj, faktet e tilla vërtetohen edhe nga dëshmitë e të dëmtuarve-dëshmitarëve dhe pjesërisht edhe nga deklarata e vet të akuzuarve dhe provave materiale të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Faktet kontestuese:

Kontestuese ka qenë fakti nëse të akuzuarit në natën kritike me veprimet e tyre a kishin kishin qëllimin dhe dashjen për ta privuar nga jeta tani të ndjerin.

Gjykata nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësor, ka vërtetuar faktin se natën kritike me dt.24.11.2017 derisa tani i ndjeri ishte duke festuar ditëlindjen e një shoku ne kafiterine “Francisko” në rrugën “Fehmi Agani” në Prishtinë, së bashku me të dëmtuarit-dëshmitarët B.S, L.K, F.F, R.K dhe M K, i njëjti del nga lokali dhe pas tij dalin dhe i dëmtuari Behar dhe të dëmtuarit-dëshmitarët e tjerë, ku pas një fjalosje mes tani të ndjerit dhe të akuzuarit A.A, ky i fundit largohet nga vendi i ngjarjes dhe kthehet së bashku me të akuzuarin A.V me veturën e tipit S. ngjyrë e kuqe me targa 01-936JN dhe deri sa vetura ishte në lëvizje i pandehuri A.V nga ulësja e pasagjerit ka shtënë dy herë me revolen e tipit TT me numër serik XB 23930945 e kalibrit 7.62mm, në drejtim të vëllezërve S dhe duke i rrezikuar persona tjerë që gjendeshin në afërsi, me crast predha e rikoshetuar godet tani të ndjerin N.Sn në pjesën e pasme të shpatullës së majtë ndërsa këmishëza e plumbit e godet në gishtin e mesëm të dorës së majtë të dëmtuarës R.K, e kjo është vërtetuar edhe nga Raporti i autopsisë MA 17-319 nga eksperti Dr. Arsim Gërxhaliu për të ndjerin N.S nga i cili rezulton se deri tek vdekja e tani të ndjerit N.S ka ardhur si pasojë e veprimit dinamik të armës së zjarrit, mendimi i ekspertit mjekoligjor Dr. Arsim Gërxhaliu për të dëmtuarën R.K nga i cili rezulton se e dëmtuara R.K nga e shtëna me armë nga ana e të pandehurit A.V, e njëjta pësoi lëndime të rënda trupore, mendimi i ekspertit të balistikës Prof. Hazir Kelmendi i dt: 16.02.2018 i cili në hollësi ka përshkruar trajektoret e predhave të armës me të cilat është qëlluar tani i ndjeri. Të akuzuarit pas gjuajtjes me armë zjarri me veturën S. janë larguar nga vendi i ngjarjes kanë bërë një gjysëm rreth dhe më pas janë kthyer sërish në vendin e ngjarjes me crast i pandehuri A.V i cili gjendej në ulësen e pasagjerit më gjysmën e trupit të nxjerrë nga dritarja e përparme ka shtënë edhe një herë me armën e zjarrit derisa vetura ka qenë në lëvizje, ndërsa më pas janë larguar nga vendi i ngjarjes. Gjykata ka vërtetuar faktin se nga këto gjuajta është rrezikuar edhe jeta e tashmë të dëmtuarve B.S, L.K, F.F, R.K dhe M K, të cilët në momentin e shtënjes me armë gjendeshin jashtë lokalit, në afërsi të makinës BMW, së bashku me tani të ndjerin N.Sn. E gjithë këto fakte gjykata i ka vërtetuar edhe nga shiqimi i CD-së me video inqizim nga vendi i ngjarjes të nxjerrura nga kamerat e sigurisë nga lokali “Optika” dhe videoincizimet janë marrë me datë 24.11.2017, në periudhën kohore nga ora 01:00:12 dhe ngjarja zhvillohet deri në orën 01:52 sipas kohës si videoinqizimit. Gjykata vërtetjon fatkin se të të pandehurit ka ekzistuar dashja për të privuar nga jeta të ndjerin N dhe rrezikim e jetës të dëmtuarve, pasi që i pandehuri A ka qenë duke vozitur veturën Seat dhe gjatë lëvizjes së veturës i pandehur A nga ana e pasagjerit shtën në drejtim të të ndjerit N e kjo vërtetohet edhe nga dëshmia e dëshmitarit L i cili ka deklaruar se “ *Ka qenë vetura e njëjtë Seat me ngjyrë të kuqe dhe një person në ulësen e pasagjerit i cili ka qenë me armë në dorë, dorën jashtë xhamit të veturës duke shti në drejtim të vëllezërve S e që ishin në një distancë shumë afër mes veturës Seat dhe vëllezërve S. Vetura Seat ka qenë në lëvizje dhe nuk është ndalur as kur ka gjuajtur. Vetura ka qenë me një shpejtësi mesatare. Herën e parë sa më kujtohet kanë qenë dy të shtëna. Gjykata*

vërteton se shkrepija e armës e cila ka qenë nga vetura që ka qenë në lëvizje, predha godet asfaltin dhe me rikoshe është goditur i ndjeri N.

Të gjitha këto prova materiale trupi gjykues i ka vlerësuar se janë të besueshme, provat janë nxjerrë nga organet publike dhe janë siguruar në mënyrë ligjore dhe si të tilla gjykata i ka vlerësuar si prova të besueshme, po ashtu dhe deklaratave të dëmtuarve-dëshmitarve, gjykata iu dha besim të plotë sepse deklaratat e dhëna nga të dëmtuarit-dëshmitarët ishin të ndërlidhura njëra me tjetrën dhe ato qojnë te konkludimi se të akuzuarit A.A dhe A.V natën kritike kanë privuar nga jeta tani të ndjerin N.S si dhe kanë rrezikuar jetën e të dëmtuarve B.S, L.K, F.F, R.K dhe M K.

Gjatë vlerësimit të provave të prezentuar në shqyrtimin gjyqësorë që kanë të bëjnë me përgjesinë penale të të akuzuarve A.A dhe A.V, gjykata nuk ka gjetur asnjë bazë për përjashtimin apo zvoglimin e përgjegjësisë së tyre, prandaj të njëjtit i ka shpallë fajtor se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Vrasje e rëndë nga neni 179 par.1, pika 1.5 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Trupi gjykues po ashtu ka vlerësuar se në veprimet e të akuzuarve A.A dhe A.V formësohen të gjitha elementet subjektive dhe objektive se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale vrasje e rëndë nga neni 179 par.1 nënpar 1.5 lidhur me nenin 31 të KPRK-së e cila shprehimisht ka përcaktuar se : *“privon nga jeta personin tjetër dhe me atë rast me dashje e vë në rrezik jetën e një ose më shumë personave tjerë”*, ndërsa sipas dispozitës së nenit 31 të KPRK-së bashkëkryerja ekziston *“Nëse dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thelbësisht duke i kontribuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet me dënimin e paraparë për veprën penale”*. Gjkata vlerëson se në rastin konkret plotësohen kushtet ligjore dhe ekzistojnë elementet objektive dhe subjektive të të akuzuarve se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale, me çrast i akuzuari A.A pas fjalosjes me tani të ndjerin N.S, është larguar nga vendi i ngjarjes dhe është kthyer së bashku me të akuzuarin A.V dhe derisa sa A ka drejtuar veturën e tipit S. i akuzuari A ka shtënë me armë zjarri në drejtim të tani të ndjerit N, janë larguar nga vendi i ngjarjes dhe prapë janë kthyer duke shtënë prapë me armë zjarri, e ku me veprime të tilla të akuzuarit kanë privuar nga jeta tani të ndjerin N, i kanë shkaktuar lëndime të rënda të dëmtuarës R.K si dhe kanë rrezikuar jetën e të dëmtuarve B.S, L.K, F.F, R.K dhe M K.

Këto veprime të akuzuarve lidhen ngusht me motivin dhe qëllimin për të kryer veprën penale, veprimet e tilla shpërfaqin dashjen e të akuzuarve për ta privuar nga jeta të ndjerin e duke vënë në rrezik jetën e personave të tjerë që gjendeshin afër të ndjerit, pasi që të dy të akuzuarit kanë dëshiruar kryerjen e veprës penale pasi që në veprimet e tyre shprehet një aktivitet i përbashkët funksional në tërë ngjarjen që ka ndodhur, sepse nëse njëri nga bashkëkryesit nuk do të kryente detyrën e vet vepra penale nuk do të kryhej ashtu siç ka qenë e planifikuar.

Të akuzuarit janë penalisht përgjegjës, sepse kanë poseduar aftësi intelektuale dhe volitive që e bëjnë të mundshëm të mendojnë, gjykojnë, të vendosin dhe ti kontrollojnë veprimet e tyre inkriminuese, të vëtedijshëm për rëndësin dhe pasojat e veprës penale, gjendje kjo që iu mundësoi që veprën penale ta kryejnë me vullnet dhe se kishin paraqytirim se janë duke kryer veprën penale të rrezikshmshme dhe të kundërligjshme.

Po ashtu nga provat e administruara është vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit A.V ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par 1 të KPRK-së, pasi që i njëjti ka poseduar armën me të cilën është privuar nga jeta tani të ndjerin N, i është shkaktuar lëndime të rënda të dëmtuarës R.K si dhe

kanë rrezikuar jetën e të dëmtuarve B.S, L.K, F.F, R.K dhe M K, armën me numër serik XB 23930945 e kalibrit 7.62 mm prodhim rus, në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët.

Gjykata ka konstatuar se elementet e veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, janë *“Kushdo që mban në pronësi, kontrollon ose posedon armë në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla, dënohet me gjobë deri në shtatëmbijë e pesëqind (7.500) Euro ose me burgim deri në pesë (5) vjet , sipas nenit 113 par 40. KPRK-së, kush konsiderohet Armë - çdo send ose vegël e punuar me qëllim që nën presionin e gazrave, të cilat lirohen gjatë djegies së materieve shpërthyesë, elektrike, gazrave nën presion ose energjisë tjetër potenciale, hedhë predha në formë të një plumbi të vetëm, grumbulli prej saçmash, gazi, lëngu, shigjete ose përbërësish të tjerë, që krijohet dhe përdoret për të shkaktuar lëndime trupore ose dëm fizik, qoftë edhe psikologjik, si dhe secili send tjetër, qëllimi kryesor i të cilit është kryerja e sulmit fizik ndaj integritetit fizik të njerëzve ose ndaj pasurisë. Armë po ashtu përfshinë municionin, pjesët dhe përbërësit e armëve, si dhe armët nukleare, biologjike dhe kimike. Këto në vijim janë armë: 40.1. armët e zjarrit; 40.2. armët e koleksionit; 40.3. armët pneumatike (ajrore); 40.4. armët që përdoren për shpërndarjen e gazit irritues; 40.5. armët shpërthyesë; 40.6. armët me shigjeta; 40.7. armët e ftohta; 40.8. armët për sinjalizim akustik dhe të dritës; 40.9. armët elektroshok; 40.10. armët me rrymë”*.

Vlerësimi i mbrojtjes:

Gjykata ka vlerësuar pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit A.A Av. Asdren Hoxha dhe Av. Fitim Malokaj si dhe mbrojtësit të akuzuarit A.V Av.Florent Latifaj, të theksuara në fjalën përfundimtare, të paraqitur me shkrim dhe të elaboruara edhe me gojë gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Mbrojtësit e të akuzuarve, gjatë gjithë kohës e kanë kundërshtuar një pretendim të tillë të prokurorisë për dashjen për ta privuar nga jeta të dëmtuarin, se të akuzuarit nuk kanë vepru me dashje të drejtëpërdrejt, se personi që ka shti me armë natën kritike ka qenë jo më larg se 2 metra nga i ndjeri dhe ka shti me dorën te poshtë pra jo në drejtim të trupit të ndjerit, gjithashtu nuk ka ekzistuar as dashja eventuale e të akuzuarve, e meqenëse nuk është vërtetuar në asnjë mënyrë ekzistimi i dashjes dhe marrëveshjes paraprake si elemente qenësore të veprës penale Vrasje e rëndë në bashkëkryerje ka konsideruar se natën kritike në veprimet e të mbrojturve të tyre manifestohen elementet e veprës penale Ndhima nga neni 33 të KPRK-së lidhur me veprën penale shkaktim i rrezikut të prgjithshëm me pasoja fatale nga neni 365 par 5 të KPRK-së, e kjo për faktin se natën kritike është shtënë në drejtim të asfaltit pra ka ekzistuar dashja vetëm për shkaktim të rrezikut të përgjithshëm kurse A.A me vënien e mjeteve në dispozicion i ka dhënë ndihm një personi në kryerjen e veprës penale shkaktim i rrezikut të përgjithshëm me pasoja fatale.

Trupi gjykues, pretendimet e theksuara si më lartë nga mbrojtësit e të akuzuarve, i ka vlerësuar si të pabazuara, të pa mbështetshme në asnjë provë të cilat janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor, gjithashtu këto pretendime nuk gjejnë mbështetje as në dëshminë e të dëmtuarve-dëshmitarëve, të cilët në mënyrë që qartë dhe bindëse e kanë përshkruar ngjarjen e natës kritike.

Gjykata duke vlerësuar me ndërgjegje të gjitha provat dhe deklaratimet e të dëmtuarve-dëshmitarëve e vërtetoi gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike nga dëgjimi i të dëmtuarve-dëshmitarëve dhe administrimi i provave materiale. Të dëmtuarit-dëshmitarët B.S, L.K, F.F, R.K dhe M.K kanë deklaruar se të akuzuarit natën kritike derisa sa kanë qenë duke festuar ditëlindjen e Fit në kafiterinë “Francisko”, ku tani i ndjeri ka dal nga lokali e pas tij kanë dal edhe të dëmtuarit-dëshmitarët, dhe pas një

mosmarrëveshje mes të tani të ndjerit dhe të pandehurit A.At, i njëjti është larguar nga vendi i ngjarjes dhe është kthyer së bashku me të akuzuarin A.V dhe derisa vetura ka qenë në lëvizje i akuzuari A.V ka dal nga dritarja e pasagjerit duke shtënë me armë zjarri me crast i ndjeri N.S ka marrë plagë dhe pas dërgimit në QKUK i njëjti ka ndërruar jetë nga plagët e marra, ndërsa e dëmtuara R.K ka pësuar lëndim në gishtin e mesëm, e në këtë rast të dëmtuarit kanë qenë në afërsi në vendin e ngjarjes dhe kanë deklaruar së e kanë ndjerë veten të rrezikuar nga të shtënat e armës së zjarrit.

Gjykata këto fakte i vërtetoi edhe me administrimin e të gjitha provave materiale dhe atë nga prova materiale – Raporti i Autopsisë Ma17-319 nga eksperti mjekoligjor Dr.Arsim Gërxhaliu për të ndjerin N.S ku është konstatuar se vdekja e të ndjerit N.S ka ardhë si pasojë e Tamponadës së zemrës të shkaktuar nga dëmtimi traumatik i arteries pulmonare e cila ka ardhë si pasojë e plagëve me armë zjarri në krahëror. Po ashtu nga mendimi i ekspertit mjekoligjor Dr.Arsim Gërxhaliu për të dëmtuarën R.K konstatohet se: Dëmtim nga arma e zjarrit, Fracture, Amputim i pjesës distale të gishtit të tretë të dorës së majtë, natyra e dëmtimeve të tilla në bazë të dokumentacionit mjekësor present dhe ekzaminimit objektiv kualifikohet në Dëmtim të rëndë trupor e shoqëruar me dëmtim të përhershëm të shëndetit.

Po ashtu gjykata këto fakte i vërtetoi edhe në mendimin e ekspertit të balistikes Prof. Hazir Kelmendi i dt: 16.02.2018 i cili në hollësi ka përshkruar trajektoret e predhave të armës me të cilat është qëlluar tani i ndjeri, raportet e ekspertimit me nr. AKF 2018-0104/2018-99, i dt. 24.01.2018, AKF 2018-0104/2018-98 i dt: 25.01.2018, AKF 2018-0104/2018-0008 i dt.23.01.2018, AKF 2018 -0104/2018-0008 i dt. 26.01.2018 të cilat janë elaboruar më lartë.

Lidhur me vendimin për pikën II:

Meqë i akuzuari A.A në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë sa përket pikës II të dispozitivit të aktakuzës, konkretisht veprës penale nga neni 374 par.1 të KPRK-së, pasi e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë për kryerjen e veprës penale, pranim i cili është bërë vullnetarisht, dhe në konsultim të mjaftueshëm me mbrojtësin, pranim i cili mbështetet në faktet e çështjes dhe provat materiale që përmban aktakuza, dhe se nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabim faktik, Gjykata vlerësoj se janë përmbushur të gjitha kërkesat ligjore nga neni 248 të KPPRK-së, që të pranohet deklarata e të akuzuarit për pranimin e fajësisë për kryerjen e kësaj vepre penale, dhe të njëjtën edhe e ka aprovuar, pasi që pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe ka mbështetje në provat tjera të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Lidhur me vendimin për pikën III:

Trupi gjykues po ashtu ka vlerësuar se në veprimet e të akuzuarit A. V. formësohen të gjitha elementet subjektive dhe objektive të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, si në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e tretë të këtij aktgjykimi, me ç`rast i akuzuari pa autorizim dhe pa leje përkatëse, ka poseduar armë në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët, edhe atë revolen me të cilën e ka kryer vrasjen e tani të ndjerit N.S i është shkaktuar lëndime të rënda të dëmtuarës R.K si dhe kanë rrezikuar jetën e të dëmtuarve B.S, L.K, F.F, R.K dhe M K, armë e tipit TT me numër serik XB 23930945 e kalibrit 7.62 mm, prodhim rus.

Caktimi i llojit dhe lartësisë së dënimit:

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPRK-së, si rrethana lehtësuese për të pandehurin A.A mori se i njëjti ka shpreh keqardhjen për rastin e ndodhur, ndërsa si rrethanë rënduese trupi gjykues vlerësoi shkallën e lartë të dashjes për kryerjen e veprës penale, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale dhe sjelljen e tij gjatë dhe pas kryerjes së veprës penale. Si rrethanë rënduese gjykata gjeti se i akuzuari Arlind me veprimet ka reflektuar një shkallë të lartë të pjesëmarrjes në veprën penale, i njëjti ka pasur mundësi që të menjanojë pasojën, të largohet nga vendi i ngjarjes pas mosmarrëveshjes që kishte me të ndjerin duke evituar kështu përshkallëzimin e konfliktit, por i njëjti ka qenë këmbëngulës me çrast pas fjalosjes me të ndjerin ka shkuar e ka marrë të akuzuarin A.V është kthyer në vendin e ngjarjes duke i mundësuar të akuzuarit A që të qëllonte me revole në drejtim të vëllezërve S dhe duke i rrezikuar persona tjerë që gjendeshin në afërsi të ndjerit, mandej janë larguar nga vendi i ngjarjes dhe prapë janë kthyer duke shtënë prapë me armë zjarri. Po ashtu si rrethanë rënduese për të pandehurin A.A gjykata mori parasysh edhe faktin se i njëjti ka të kaluar kriminale ku gjykata gjeti ekzistencën e dy dënimeve penale për grabitje dhe keqpërdorim seksual.

Sa i përket veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll dhe posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, për të akuzuarin A.A gjykata si rrethanë lehtësuese ka vlerësuar faktin se i njëjti e ka pranuar fajësinë për këtë veprë penale, pranim ky i cili është bërë që në fillim të kësaj procedure penale.

Për të akuzuarin A.V trupi gjykues me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi rrethanat në kuptim të nenin 73 të KPRK-së, si rrethanë lehtësuese vlerësoi se i njëjti shprehu keqardhje për rastin që ka ndodhur, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata vlerësoi shkallën e lartë të dashjes për të kryer veprën penale, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale dhe sjelljen e tij gjatë dhe pas kryerjes së veprës penale, manifestimin e këmbëngulësisë për kryerjen e veprës penale, këmbëngulësisë e cila manifestohet se i njëjti ka shtënë me armë zjarri nga dritarja e veturës e cila ishte në lëvizje në drejtim të vëllezërve S dhe duke i rrezikuar persona tjerë që gjendeshin në afërsi dhe pasi largohen prapë kthehen dhe i njëjti prapë ka shtënë me armë zjarri dhe largohen nga vendi i ngjarjes me shpejtësi.

Gjykata është e bindur se me anë të këtyre dënimeve ndaj të akuzuarve është e pritshme që të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë me nenin 41 të KPRK-së dhe me këto dënime ndaj të akuzuarve që janë në proporcion me peshën e veprave penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarve, rrethanat dhe mënyrën e kryerjes së veprave penale dhe personalitetin e të akuzuarve, ka vlerësuar se do të arrihet qëllimi i dënimit dhe atë parandalimi i të akuzuarve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe njëkohësisht do të arrihet edhe qëllimi tjetër që të përmbaj personat tjerë nga kryerja e veprave penale (preventiva gjenerale).

Vendimi mbi llogaritjen e kohës së qëndrimit në paraburgim për të pandehurit u mor në pajtim me nenin 83 të KPRK-së.

Shpenzimet e procedurës:

Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës penale kundër të akuzuarve, do të merret në bazë të llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, ndërkaq shpenzimet në emër të paushallit gjyqësor janë marrë, duke pasur për bazë ndërlikueshmërinë e veprës penale, kohëzgjatjen e zhvillimit të procedurës penale si dhe gjendjen pasurore të të akuzuarës, konform nenit 450 par.3 të KPRK-së.

Dënimi plotësues:

Konform nenit 374 par.3 të KPRK-së, gjykata ndaj të pandehurve ka shqiptuar edhe dënimin plotësues ashtu që ka urdhëruar konfiskimin e detyrueshëm e të përhershëm të armëve dhe atë: Revolja e tipit “TT” me nr.XB23930945 e kal 7.62 prodhim rus dhe Revolja e tipit “Ekol Special” e kal 9 mm me nr.serik EV16120999, me nje karikator me 7 fishekë si dhe 12 fishekë tjerë të kal.7.355 mm.

Kërkesa pasurore juridike:

Vendimi mbi udhëzimin e palëve të dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest të rregullt civil, është marrë pasi që palët e dëmtuara nuk e kanë precizuar kërkesën në mënyrë të qartë, dhe duke mos ia bashkangjitur provat konkrete, ashtu që, të dhënat e mbledhura në procedurë penale, nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtë lidhur me këtë çështje, konform nenit 463 par.2 të KPPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në pajtim me dispozitat ligjore nga neni 364 dhe 365 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ps.Me aktvendim GJA.nr. 1077/2022, është zgjatuar afati ligjor për përpilimin e këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINE
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA ,**

2019:088625, 16.01.2023

G j y q t a r i

Alban Ajvazi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.